Die Frauenfiguren im frühen Romanwerk sind meistens idealisiert, ihre Rolle und ihre Funktionen werden nur leicht und unbedeutend dargestellt, d.h. ihr Dasein ist nicht wichtig für die männlichen Hauptrollen. Hesse war schüchtern und machte in seiner Jugend kaum Erfahrungen mit Frauen. Seine Mutter Marie Hesse war Missionarstochter, und wurde von ihrer calvinischen Mutter sehr streng erzogen, sie repräsentierte somit für ihre Kinder ein bestimmtes Frauenbild. Hugo Ball hat als erster und in unverkennbarer Deutlichkeit gezeigt, dass die Mutterproblematik und das Muttersymbol ihren Ursprung haben

Sie (Marie Hesse) liebt sehr die Poesie, sie dichtet selbst und rezitiert mit schöner, begeisterter Stimme Balladen sie liebt Musik und hat die Stimme wie eine helle Glocke, doch sie liebt im Grund nur Psalmen und Chorale. Eine warme Kälte strömt von ihr aus. Ihr französisches Calvinistenblut hat eine Leidenschaft für das Unbedingte, das Letzte und Höchste im Leben, eine Leidenschaft, die der Sohn mit ihr teilt. Ihre Ehe dient den Zwecken der Mission und der Verbreitung des Evangeliums. Ihre Liebe ist von Gott und für ihn, nicht von den Menschen und für die Menschen. Sie liebt ihre Kinder aber als Geschöpfe Gottes, und sie wurde sich einen Skrupel und eine Selbstanklage daraus machen, diese ihre Kinder einem armen Waisenkinde vorzuziehen. Diese Mutter ist unzugänglich für jeden sinnlichen Impuls, für jede narzisstische Eigenliebe, die um sie werben konnte¹

2.2. Einfluss Maria Hesse: Mütterlichkeit

Marie Hesse starb 1902. Hermann Hesse war damals 24 Jahre alt, er war ein sehr muttergebundener Mensch und verehrte sie sehr. Zwei Jahre später heiratete Hesse Maria Bernoulli, die neun Jahre älter als er und seiner Mutter in vielen Wesenszügen sehr gleich war. Nach der Entstehung der ersten Ehe von Hesse veränderten sich die Grundstrukturen der Frauenfiguren. Maria war eine ernsthafte mütterliche Frau, unter deren Einfluss die Idealfrau im Roman durch die Ehefrau ersetzt wurde. Sie leidet im Alltagsleben unter ihrem Gatten, versteht ihn und sein künstlerisches Leben nicht, anschließend ist sie das Opfer der tragischen Ehebeziehung. Im frühen Romanwerk werden keine individuellen Frauen dargestellt, sie haben keine sinnliche Seite. Die einzige Funktion der Frauenfigur ist die der Helfern auf dem Weg zur Selbstverwirklichung des Helden.

3. Peter Camenzind

3.1. Entstehung des Romans

Der Roman „Peter Camenzind“ entstand 1901-1903 in Basel, erschien 1904 bei S.

¹ Ball, Hugo Hermann Hesse Sein Leben und sein Werk, Frankfurt a. Main 1977, S. 56.

Fischer in Berlin. Wie all seine Werke bedeutet dieser Roman eine Stufe in Hesses Entwicklung

1899 verließ Hesse Tübingen, 1901 machte er eine Reise nach Italien, dann ging er nach Basel, wo er seine Kindheit verbracht hatte. In Basel entwickelte Hesse eine positive Beziehung zur bildenden Kunst. Dort fand er auch die richtige Umgebung, die der neuen Philosophie von Nietzsche und Burckhardt. Mit dem Bildungsroman wurde Hesse schlagartig berühmt.

Der Roman war trotz des Einflusses Gottfried Kellers sowie der Beschäftigung mit dem Geist und dem Leben Franz von Assisis auf dem Grund seiner eigenen Erlebnisse aufgebaut. Peter Camenzind hatte sehr viele identische Züge mit Hesse, er wendete sich von der Welt und Gesellschaft ab, wollte Dichter werden. Er konnte den Grund seiner Unzufriedenheit nicht in der Gesellschaft finden, ging nun eigensinnig seinen eigenen Weg. Er wollte sich nicht anpassen, sondern in seiner eigenen seelischen Welt leben, in seiner Einsamkeit das Ziel, erwachsen und reif zu sein, verwirklichen. Peter Camenzind war von außen gesehen im Vergleich zu den anderen jungen Studenten schüchtern und unsympathisch, aber innerlich umfasste er das Leben. Aus seiner vielen un schönen Erlebnisse lernte er das eigene Leben zu bestimmen und zu beherrschen

3.2. Analyse des Romans

Peter Camenzind stammte aus einem Bergdorf in der Schweiz. wo sich viele Familien auch Camenzind nannten. Die schöne Landschaft und die harte Umgebung bestimmten den Charakter Peter Camenzinds, ließen ihn anders sein als seine Mitmenschen. Es kam für ihn die Gelegenheit eine Klosterschule zu besuchen. In der Schule war er eher schüchtern, blieb ein Einzelgänger. Sein großes Vorbild war Franz von Assisi

3.2.1. Das Frauenbild Peter Camenzinds

Die Gestalt seiner Mutter wurde deutlich beschrieben.

Die Mutter war ehemals schon gewesen, davon war aber nur der feste, grade Wuchs und die anmutigen, dunklen Augen übriggeblieben Sie war groß, überaus kräftig, fleißig und still. Obwohl sie reichlich so klug wie der Vater und an Körperhaft ihm überlegen war, herrschte sie doch nicht im Haus, sondern ließ das Regiment ihrem Manne.²

Das Familienleben und die sozialen Bedingungen bestimmten die Beziehung zwischen Mann und Frau. Obwohl die Frau vom Aussehen und Innern vielleicht sogar stärker war als der Mann, durfte sie nur hinter dem Mann stehen. Vor diesem Hintergrund hatte Peter Camenzind sein Frauenbild:

Von der Mutter her und auch aus eigenem, undeutlichem Gefühl verehrte ich die Frauen insgesamt als ein fremdes, schönes und rätselhaftes Geschlecht, das uns durch eine angeborene Schönheit und Einheitlichkeit des Wesens überlegen ist und das wir heilig halten müssen, zwar blieben die Frauen auf dem hohen Sockel stehen, mir aber verwandelte sich die feierliche

² Hesse, Hermann: Die Romane und die Großen Erzählungen, Jubiläumsausgabe zum hundertsten Geburtstag von Hermann Hesse, Frankfurt am Main 1977, Erster Band Peter Camenzind, Unterm Rad, S 22.

Rolle des anbetenden Priesters allzuleicht in die peinlich komische des genarrten Narren.³ Peter Camenzind sah die Frau als ein höheres Wesen, das ihm zwangsläufig fremd erscheinen musste, wenn er sich in diesem Feld von Liebe noch nicht weit entwickelt ansah, und sich der Frau gegenüber minderwertiger fühlte. Er schuf durch diese Einstellung eine Distanz zwischen der Frau und sich, hielt diese Distanz in seiner Entwicklung sehr fest. Einen Teil seiner Mentalität hatte er von seiner Mutter erhalten, „Von der Mutter eine bescheidene Lebensklugheit, ein Stück Gottvertrauen und ein stilles, wenig redendes Wesen“⁴

Der Einfluss von der mütterlichen Seite bestimmte, dass Peter Camenzind eine ganze Weile einsam blieb und keinen Erfolg in der Liebe haben konnte.

3.2.2 Rösli: Erste Liebe in der Klosterschule

In der Schulzeit verliebte sich Peter Camenzind in die Advokatentochter Rosi Girtanner die erst siebzehn Jahre jung und recht schön war. Die Liebe zu Rosi war eigentlich die Verehrung und Schwärmerei von einem noch nicht erwachsenen Jungen, der keine konkrete Darstellung von der Frau und keine direkte mit ihr hatte. Peter Camenzind hatte nie Kontakt mit Rosi, hielt die ferne Liebe. Für sie erstieg er unter viel Anstrengung einen Berg, um einen Strauß einer seltenen Art von Alpenrosen zu holen. Als er zurückkam, legte er den lieben Gruß auf die Treppe, ohne dass sie jedoch davon erfuhr von wem die Blumen wäre. Der erste Liebeskummer, von dem Rösli nie etwas erfuhr, fand keinen Abschluss.

Die Erklärung bekam Peter Camenzind später in einer Ausstellung, wo er in einem Bild der schönen Fuggertochter sein Schicksal sah. Das edle und vollendete Schönheitsideal blieb ein Bild, weit entfernt von individuellem Menschsein. Er war in der Wirklichkeit nicht in eine Frau verliebt, die aus Fleisch und Blut war, sondern in ein Bild, das seinen idealen Wunsch bedeutete

*...ich bin stolz darauf, dass ich mein Leben lang immer nur in sehr schöne Frauenbilder verliebt war*⁵

In ein Frauenbild verliebt zu sein ist leichter als in eine leibhaftige Frau, weil diese reagieren konnte, das Bild aber immer wie gewünscht blieb. Peter Camenzind hatte einerseits Sehnsucht nach der echten Liebe, andererseits hatte er Angst davor, dass nicht alles nach seiner romantischen Darstellung laufen würde. Er traute sich gar nicht erst, es zu riskieren, genoss lieber das Gefühl, das er bei dem Anblick des Bildes aus dem 17. Jhd. verspürte.

3.2.3. Aglietti: Unerwiderte Liebe

Nachdem seine Mutter gestorben war, verließ Peter Camenzind sein Dorf, und begann sein Studium in der Stadt. Er blieb am Anfang zurückhaltend, bis eines Tages ein junger Musiker Richard zu ihm kam. Die beiden wurden gute Freunde, und genossen ihre frohe männliche Freundschaft. In einer Ausstellung stellte Richard Peter Camenzind ein Bild von einer Malerin Erminia Aglietti vor. Bei dem ersten

³ Hesse, Hermann Erster Band Peter Camenzind, Unterm Rad. S. 29.

⁴ Ebda, S. 23.

⁵ Ebda, S. 27.

Besuch bewunderte Peter Camenzind die Malerin gar nicht, im Gegenteil: *Die Gestalt wurde durch den langen Schurz verdeckt und entstellt, und das Gesicht erschien mir nicht schön. Der Schnitt war scharf und knapp die Augen ein wenig streng das Haar reich schwarz und weich, was mich störte und fast abstieß, war die Farbe des Gesichts. Sie erinnerte mich schlechterdings an Gorgonzola, und ich wäre nicht erstaunt gewesen, grüne Ritzen darin zu finden... Ich war auch nicht gewohnt ein Frauengesicht auf seine Formen zu prüfen, sondern pflegte in solchen noch in etwas knabenhafter Weise mehr nach Schmelz, nach Rosigem, nach Liebreiz zu suchen.*⁶

Hier wurde das ideale Frauenbild von Camenzind deutlich beschrieben. In seine Vorstellung gehörten nur die schönen Frauen hinein, die fraulich und lieblich aussahen. Die Vorstellung, bzw. das ideale Frauenbild ist unrealistisch, solche Anima würden nicht in der Wirklichkeit existieren. Peter Camenzind gab sich seiner Schüchternheit wegen auch keine Mühe, die ideale Frau kennenzulernen.

Die Malerin Aglietti erreichte seine Vorstellung noch nicht, ihre eigentlich individuelle Wesensart wurde von Camenzind erst später erkannt. Peter Camenzind war fleißig in dem Beruf als Schriftsteller, er wurde erfolgreich und selbstsicher. Er wurde von Malerin Aglietti auf eine Party eingeladen. Peter Camenzind blieb allein, unterhielt sich mit niemanden, geriet auch noch in eine unangenehme Situation, sodass alle über ihn gelacht hatten. Das konnte der schüchterne und empfindliche Camenzind nicht leiden, wollte gehen. Doch dann kam seine Anima ihn zu retten. Die Malerin Aglietti setzte sich neben ihn und sie unterhielten sich. Das war das erste Mal in seinem Leben, dass eine Frau zu ihm ging und ihn hoch achtete. Es war für ihn ungewohnt, aber es hat ihm gut gefallen, so wurde die Malerin in den Augen Camenzinds schöner, der erste Eindruck von „Gesichtsfarbe wie Gorgonzola“ war verschwunden. Camenzind fand das Gespräch mit der schönen Malerin einen „köstlichen Genuss“. Camenzinds Beobachtung der Frau hatte sich danach von der rein äußeren auf die innere Seite verlegt:

*sondern hatte den köstlichen Genuss sie ihre Sprache reden zu hören, die Sprache die ihrem Mund und ihren Augen und ihrer Gestalt entsprach, die wohllaute elegante raschfließende lingua Toscana mit einem entzückenden, leichten Anflug von Tessinerwelsch.*⁷

Peter Camenzind erkannte plötzlich die Innerlichkeit dieser Frau, die in seine Traumgestalt passen würde. In dem Augenblick, in dem die Frau kein Traumideal, sondern eine eigene Identität für ihn war, verliebte er sich in sie. Die gleiche Frau wurde auf einmal ein Engel. Sie trafen sich fast jeden Tag. Die Werke der Malerin konnten Camenzind nicht überzeugen, aber es schadete ihrer Leidenschaft auch nicht. Camenzind respektierte ihre kämpferische Natur. Seine Beziehung zu der Frau wurde nicht nur Beobachtung und Ausweichen, sondern mutiges Verhalten. Auf einem Sommerfest versuchte Peter Camenzind ihr eine Liebeserklärung zu machen. Weil er gar keine Erfahrung hatte, wusste er nicht, wie er anfangen soll, er bat sie eine Liebesgeschichte von ihr zu erzählen. Aglietti fand seine Vorstellung lustig, ihre Ansicht war ganz anders als die Camenzinds. Sie sagte ihm, dass er sich in ihr getauscht habe und sie in einer sehr innerlichen Liebesbeziehung lebe. Camenzind war schockiert und enttäuscht, er fühlte sich von Aglietti entfremdet und wendete sich wieder an Richard. Camenzind wurde von dieser Erfahrung mit der Frau enttäuscht,

⁶ Hesse, Hermann Erster Band Peter Camenzind, Unterm Rad, S. 52.

⁷ Hesse, Hermann: Erster Band Peter Camenzind. Unterm Rad. S 57.

und blieb zurückhaltend. Von der Freundschaft mit Richard bekam Peter Camenzind nun alles, was er von den Frauen nicht bekommen konnte, er wurde beruhigt, denn er vertraute seinem Freund. Sie konnten sich ohne Schwierigkeiten miteinander verständigen. Die schöne männliche Beziehung endete mit der Todesnachricht von Richard, der in einem Fluss in Süddeutschland ertrank.

3.2.4. Elisabeth: Eine weiße Wolke

Peter Camenzind hatte seinen einzigen treuen Freund verloren, aber er musste weiter seines Weges gehen, um sein inneres Ich zu finden. Er kehrte nach Basel zurück, traf dort wieder eine schöne Frau, die ideale Anima zu seinem Geist. Elisabeth stammte aus einem guten Haus, verstand Kunst, und hörte Camenzind geduldig zu. Da er von den Frauen enttäuscht worden war, blieb er von Elisabeth fern. Aber seine innige Liebe neigte sich ihr zu, sodass er sich entschloss, sie zu heiraten, denn „glaubte ich mein Schicksal zu erkennen, das mir in der Möglichkeit einer Liebesehe die Brücke zur Menschenwelt schlagen wollte.“ Durch die Eheschließung mit einer Frau wollte er die Beziehung zur Welt wieder aufnehmen.

Die ideale Schönheit musste auch sonderbar sein, Elisabeth z.B. war Symbol für eine hohe aber ferne Weiblichkeit. In einem Gedicht wurde Elisabeth in eine weiße Wolke verwandelt, womit klar ist, dass Elisabeth nur als Symbol genutzt wurde sie verlor ihre menschlichen Werte, trug die symbolischen und geistlichen Züge nach den Peter Camenzind ohne Bewusstsein Sehnsucht hatte.

Dann war auch das Ende dieser Liebesgeschichte gekommen. Peter Camenzind konnte seinen Wunsch, schöne Elisabeth zu heiraten, erfüllen, da sie schon mit einem anderen Mann verlobt war. Er war enttäuscht vom bürgerlichen Glück und fuhr nach Italien, wo er mehr Kontakt mit Menschen und mit der Natur hatte. Weil er kein Glück mit Frauen hatte konnte er seinen eigenen Weg weitergehen. Die schöne Elisabeth ist eine gute Anima, die Peter Camenzind seinen Weg indirekt zeigt. Die Frauengestalt ist wunderschön, nicht nur äußere sondern auch innerliche Schönheit. Peter Camenzind half dem Krüppel Boppi. Boppi war von der Geschichte von Elisabeth und Peter Camenzind begeistert und wollte Elisabeth einmal sehen. Um Boppi eine Freude zu machen, kam Elisabeth in den Tiergarten, begegnete Boppi und erfüllte somit seinen Wunsch.

Nach vielen Kritiken scheint es, dass Elisabeth eine Frl. La Roche sein sollte. Elisabeth La Roche war die Tochter des Pfarrers Emmanuel La Roche, die Hesse im Februar 1900 bei einem Musikabend im Haus des Historikers und Staatsarchivars Rudolf Wackernagel kennengelernt hatte, sie war Tänzerin und Choreographin. In einem unveröffentlichten Roman „Der Dichter (1901) wurde Elisabeth so dargestellt:

Ein eleganter geistreichschöner Kopf mit lebendig beweglichen Zügen, mit hoher Stirn und kühlem klugen Blick, mit schmalen Lippen auf welchen Sinnlichkeit und Skepsis stritten, und mit dem vielbewunderten präraffaelitischen Kinn.⁸

Hier wurde Elisabeth auch vergeistlicht es ist ein geeignetes Sinnbild für Hesse.

⁸ Michels, Volker (Hrsg) Hesse Sein Leben in Bildern und Texten, Frankfurt am Main 1979. S. 73.

3.2.5. Nardini: Naturhafte Seite

Nachdem das gemeinsame Leben mit seinem Vater scheiterte, fuhr Peter Camenzind nach Italien, dort lernte er die Gemüsehändlerin Annunziata Nardini kennen, die ihn heiraten wollte. Aber für sein hohes geistliches Bedürfnis war die Gemüsehändlerin zu natürlich und niedrig. *Früher hatte ich geglaubt es müsse ein besonderer Genuss sein geliebt zu werden, ohne selbst zu lieben. Ich hatte jetzt erfahren, wie peinlich eine solche sich anbietende Liebe ist die ein Mann nicht erwidern kann.*⁹

Er konnte sie nicht lieben, ihre Liebe tat ihr nur leid. Er konnte Elisabeth in der Realität nicht bekommen, er genoss die ferne Liebe zu ihr wie zuvor, die geistliche Liebe trieb die natürliche Liebe weg. Peter Camenzind blieb immer allein und hatte Misstrauen gegen die Frauen. Er zeigte sich nicht mehr vor der Frau, sondern beobachtete die Frau, ohne bemerkt zu werden, er lebte in seiner Illusion. Peter Camenzind kehrte in sein Dorf zurück, pflegte den Krüppel Boppi bis zu dessen Tod. Da lernte er die befreiende Erkenntnis, ging auf seinem Entwicklungsweg weiter.

3.3. Frauen als ferne Schönheit

Der Roman war der erste Erfolg für Hesse, und trägt viele biographische Züge von ihm selbst. Hesse besuchte auch eine Klosterschule, genau wie Peter Camenzind, lebte in Basel, und verehrte die schöne Elisabeth.

Das Problem des Künstlers war der Konflikt zwischen Natur und Geist. Hesse versuchte die Antwort in der Entwicklung Peter Camenzinds zu finden. Die Frauenfiguren haben in dem Roman die Funktion, Peter Camenzind zu fördern, sich selbst zu entwickeln. Die ferngebliebene Rosi und das Schönheitsideal Elisabeth sind nur ein Symbol für ihn. In der Wirklichkeit war er nicht in die Frauen verliebt, sondern in sein eigenes Idealbild. Die Anima ist ja Metapher zu dem Symbol. Peter Camenzind hatte Schwierigkeiten, eine echte Beziehung zu einer Frau aufzubauen, er neigte dazu, über sie zu phantasieren, anstatt sich ihr tatsächlich zu nähern. Seelisch war dies eine Gefahr, da er auf diese Art und Weise niemals zu einer wirklichen Beziehung zu seiner Anima gelangen konnte, weil er nie einen innigen Kontakt zu einer Frau hatte. Die Malerin Aglietti erschien ihm bei der ersten Begegnung als nicht schön, weil sie menschliche Züge trug. Als er ihre individuelle Mentalität erkannte, verliebte er sich in sie, aber er war unfähig zu der menschlichen Liebe. Er wusste von dieser Unfähigkeit, deshalb lehnte er die Liebe der Gemüsehändlerin Nardini ab. Die Malerin und die Gemüsehändlerin sind natürlich und tragen ihre eigenen individuellen Züge. Mit den Frauenfiguren aus der Natur und aus dem Sinn lernt Peter Camenzind die Welt und die Natur kennen, er strebt von der Welt und Gesellschaft zur Natur zurück, um seinen eigenen Weg zu finden, sucht einen Sinn in seinem Leben. In dem Frühwerk Hesses finden wir die Tendenzen. Die jungen Helden sind unfähig für die menschliche Liebe. Diese Situation erklärt Hesses künstlerisches Problem, weil die Helden die Neigung zum Künstlertum haben, gehen sie in die Natur und in sich zurück, d.h. sie sind von der Realität weit entfernt. Joseph Mileck schrieb über das Ende des Romans:

Camenzinds Entschluss, der Welt den Rücken zu kehren und auf Frauen zu verzichten, war

⁹ Hesse, Hermann: Erster Band Peter Camenzind. Unterm Rad, S 110.

auch Hesses Entschluss. Und hätte Hesse seinen Peter Camenzind nicht abgeschlossen, bevor Mana Bernoulli eine völlig neue Möglichkeit in sein Leben brachte, dann hätte der Roman durchaus mit einem recht traditionellen Happy-End schließen können.¹⁰

Literatur

- Ball, Hugo Hermann Hesse Sein Leben und sein Werk, Frankfurt a. Main, 1977
Hesse, Hermann: Die Romane und die Großen Erzählungen, Jubiläumsausgabe zum hundertsten Geburtstag von Hermann Hesse, Frankfurt am Main 1977, Erster Band Peter Camenzind, Unterm Rad.
Mileck, Joseph: Hermann Hesse. Dichter, Sucher, Kenner. Biographie, München 1979
Michels, Volker (Hrsg) Hesse Sein Leben in Bildern und Texten, Frankfurt am Main 1979.

¹⁰ Mileck, Joseph: Hermann Hesse. Dichter, Sucher, Kenner. Biographie, München 1979, S. 36.

Të drejtat e të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar në procesin penal

Olgert Rumnici

Prokuror, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë

Abstrakt

Në këtë punim do të përpiqemi të trajtojmë në mënyrë të përmbledhur të drejtat e viktimës në procesin penal ose dëshmitar. Termi "viktimë" në procesin penal u prezantua për herë të parë në legjislacionin procedural penal me ndryshimet ligjore të ligjit nr. 35/2017 dhe me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (ligji nr. 37/2017). Ky term zëvendësoi termin i dëmtuar nga vepra penale që njëjtte K.Pr.Penale për subjektin, i cili pësonte dëm nga vepra penale. Ndryshimi i terminologjisë, që imponohej nga përafrimi i legjislacionit të vendit tonë me normat komunitare dhe ato ndërkombetare, u shoqërua me një konceptim të ri të pozitës së viktimës¹ në procesin penal (Direktiva 2012/29/be e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 25 tetor 2012, Mbi vendosjen e standardeve minimum për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, e cila ka zëvendësuar Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/220/JHA). Ky konceptim i ri i pozitës së viktimës në procesin penal bazohet në njohjen dhe garantimin e një sërë të drejtash, një pjesë e të cilave njihet dhe më parë, por për shkak të mungesës së mekanizmave efektivë për ushtrimin e tyre, kishin mbetur në kuadrin deklarativ. Pikërisht, evidentimi i këtyre të drejtave, disa prej të cilave kanë natyrë procedurale, do të jetë objekti i këtij punimi dhe përpjekja për të ofruar një qasje krahasuese ndërmjet Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (në vijim KDPM) dhe Kodit të Procedurës Penale (në vijim K.Pr.P) lidhur me to.

Fjale Kyçe: Të drejtat e të miturit, viktimë, dëshmitar, proces penal, Shqipëri.

1. Hyrje

Nga një krahasim i dispozitave aktuale dhe atyre përpara ndryshimeve ligjore, lidhur me të drejtat me natyrë procedurale, si njoftimi i vendimmarrjeve, njoftimi i seancës gjyqësore, e drejta për të kërkuar procedimin e fajtorit, shpërblimin e dëmit, për të kërkuar marrjen e provave etj., rezulton se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë qenë të parashikuara edhe përpara ndryshimeve ligjore të vitit 2017. Në vlerësimin tim, dallimi thelbësor ka qendruar në faktin që organet proceduese, konkretisht prokuroria në fazën e hetimeve paraprake dhe gjykata në fazën e gjykimit, përpara ndryshimeve ligjore, kanë ndjekur një praktikë të gabuar lidhur me pozitën e të dëmtuarit nga vepra penale. Ky argument merr për bazë kryesisht dhe kufizohet brenda kornizës së aspekteve procedurale të procesit penal, pasi me ndryshimet ligjore të vitit 2017 janë njohur edhe të drejta të tjera me rëndësi që kanë në thelb natyrë sociale dhe ekonomike. Megjithëse, çështja e krahasimit midis dy periudhave para dhe pas ndryshimeve ligjore të vitit 2017, mund të ketë ende vend për diskutim, trajtimi ynë fokusohet në një kategori specifike të viktimave të veprave penale, e konkretisht të miturit si viktimë në procesin penal dhe/ose si dëshmitarë.

¹ Sipas direktivës 2012/29/BE, me termin viktimë kuptohet një person fizik që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtim fizik, mendor ose emocional ose humbje ekonomike e cila është shkaktuar drejtpërdrejt nga një veprë penale

2. Ndryshimet ligjore të procedurës penale

Me ligjin 37/2017 u miratua Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili fokusin kryesor ka trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Megjithatë, një vëmendje e posaçme i është kushtuar të miturve si viktimë e veprave penale dhe/ose si dëshmitarë. Sipas relacionit për hartimin e këtij ligji, qëllimi i tij është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, integrimi social i tyre, rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dëshmitar dhe viktimë, parandalimi i viktimizimit të dytë ose ri-viktimizimit, parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë (Relacion për projektligjin “Kodi i Drejtësisë për të Miturit në Republikën e Shqipërisë, nd).

Gjithashtu, në K.Pr.Penale, me ligjin nr. 35/2017 u shtua një dispozitë e posaçme për të drejtat e të miturve viktimë të veprës penale. Përpos nenit 58 të K.Pr.Penale, i cili është riformular dhe e shtrin efektin e tij te të gjitha kategoritë e viktimave (përfshirë edhe të miturit), ligjvënësi ka vlerësuar të parashikojë specifikisht në nenin 58/a të K.Pr.Penale disa të drejta procedurale shitesë për të miturin si viktimë e veprës penale. Këto të drejta procedurale janë parashikuar në përputhje me cilësinë e veçantë të viktimës, në këtë rast mosha e tij e mitur (Relacioni për K.P.Penale Projekt Ndryshimet për Kodin e Procedurës Penale, nd).

3. Parimet mbi të cilat duhet të veprojnë organet kompetente me të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë

Parimet, të cilat duhet të udhëheqin aktivitetin e shërbimeve të policisë gjyqësore, prokurorisë, gjykatës, si edhe institucioneve të tjera që monitorojnë dhe trajtojnë të miturit, janë të shpërndara ndërmjet K.Pr.Penale dhe KDPM-së. Parimi ligjor kryesor, kur vjen fjala, për drejtësinë me të mitur, është ai i interesit më të lartë të fëmijës (KDPM-ja, neni 3, pika 9). Në nenin 10 të KDPM-së është parashikuar një dispozitë specifike për sqarimin e këtij parimi. Studiuesit e interpretojnë këtë parim si një e drejtë materiale dhe një rregull procedural, që do të thotë se duhet të trajtohet rast pas rasti, çdo herë që bëhet fjalë për të mitur, *pavarësisht statusit të tij si i pandehur, dëshmitar ose viktimë* (Mandro, A. nd).

Sipas pg.3 të nenit 10 të KDPM-së, vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit. Kjo dispozitë përmban një detyrim të rëndësishëm për organet që trajtojnë rastet e të miturve, përfshirë shërbimet e policisë, prokurorinë e gjykatën dhe synon që parimi i interesit më të lartë të fëmijës të jetësohet praktikisht. Nëse shohim elementët përbërës që parashikon kjo dispozitë për respektimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, kuptohet që ai përbën bazën e parimeve të tjera siç janë mbrojtja nga diskriminimi (KDPM-ja, neni 11), zhvillimi harmonik i të miturit (KDPM-ja, neni 12), pjesëmarrja e të miturit në proces, shqyrtimi pa vonesë i çështjeve me të mitur, pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut (KDPM-ja, neni 16, 17 dhe 18). Në nenin 33 të KDPM-së përcaktohen disa parime specifike për të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë të veprës penale, që mund të kategorizohen në trajtimin dinjitoz dhe miqësor të të

miturit gjatë gjithë procesit, duke marrë në konsideratë gjendjen e tij personale, nevojat e menjëhershme dhe të veçanta, moshën, gjininë, aftësitë e kufizuara, nëse ka, dhe nivelin e pjekurisë; mbrojtjen e jetës private; ruajtja e konfidencialitetit të të gjithë informacionit rreth të miturit të marrë për shkak të detyrës ose/dhe gjatë kryerjes së detyrës; moslejimi i publikimit të identitetit të të miturit, përveçse vetëm me vendim të gjykatës; përfitimi pa pagesë i shërbimeve që ofrohen sipas KDPM-së dhe legjislacionit në fuqi.

4. Të drejtat e të miturit viktimë/dëshmitar të veprës penale në procesin penal

Në mënyrë të veçantë, Direktiva "2012/29/EU" e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (25 tetor 2012) ka qenë një bazë e spikatur mbi të cilën është përjasur Kodi i Procedurës Penale. Konkretisht, amendamentet e tij të vitit 2017, kanë krijuar një grup të ri të drejtash për viktimën në procesin penal. Në bazë të kësaj direktive mund të kemi një klasifikim të të drejtave në kuptimin e përgjithshëm, pra, të drejta që sanksionohen për të gjitha kategoritë e viktimave. Këto, dallohen nga të drejtat në kuptim të posaçëm që lidhen me karakteristika të veçanta të viktimës së veprës penale. Të sanksionuara rishitazi në Kodin e Procedurës Penale, të drejtat në kuptimin e përgjithshëm mund të ndahen në këto nëngrupe

-Të drejtat e viktimës për informim dhe mbështetje;

-Të drejtat e viktimës për të marrë pjesë në procesin penal;

-Të drejtat që lidhen me mbrojtjen e viktimave (Anastasi, Aurela, 2019)

Këto nëngrupe të drejtash të viktimës në procesin penal rezultojnë prej të drejtave të listuara në nenin 58 të K.Pr.Penale. Duke qenë se të miturit viktimë janë një kategori e posaçme, edhe të drejtat e tyre klasifikohen si të drejta të posaçme dhe i referohen në fakt jo vetëm nevojave të veçanta që kanë të miturit, por edhe mbrojtjes së tyre së posaçme në kuadrin kushtetues, të akteve ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm. Nëse vështrojmë parimet e përcaktuara në KDPM, në Kreun II, rezulton se nuk ka një ndarje se cilat prej tyre i referohen specifiku të miturve viktimë apo të miturve në konflikt me ligjin dhe se disa prej tyre përfaqësojnë të drejta procedurale të rëndësishme në procesin penal. Gjithsesi, nga kuptimi i secilës dispozitë mund të kuptohet që një pjesë i referohen të dyja kategorive të të miturve në procesin penal, disa të tjera vetëm një kategorie, si rasti i parimit të prezumimit të pafajësisë që i referohet specifiku të miturit në konflikt me ligjin, ndërsa parimi i interesit më të lartë të fëmijës, trajtuar edhe më lart, i referohet të gjithë kategorive të të miturve, qofshin në konflikt me ligjin, viktimë apo dëshmitarë. Në krerët në vijim (kreu III dhe V) janë përcaktuar të drejtat e të dy kategorive të të miturve, në konflikt me ligjin, viktimë e veprës penale/ i mitur dëshmitar. Edhe në këto krerë, veçanërisht në kreun III, ku përcaktohen të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin, parashikohen njëkohësisht të drejta që duhet të jenë të zbatueshme edhe për të miturin viktimë e veprës penale dhe/ose dëshmitarë. Për këtë qëllim, vlerësojmë i shërben përmbajtja e nenit 24 të KDPM, i cili parashikon që: *"I mituri viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale gëzon, për aq sa është e mundur, të njëjtat të drejta të parashikuara për të miturin në konflikt me ligjin, parashikuar sipas këtij kreu, si dhe të drejtat e parashikuara në kreun V të këtij Kodi.*

4.1 E drejta e pjesëmarrjes në proces

Një prej të drejtave të rëndësishme të parashikuara në KDPM është e drejta e pjesëmarrjes në proces (KDPM-ja, neni 16), që ashtu siç është trajtuar në paragrafin më lart, duket se zbatohet si për të miturin në konflikt me ligjin, ashtu edhe për të miturin viktimë. E drejta e pjesëmarrjes në proces është reflektim i normave të gjithëpranuara ndërkombëtare, të cilat sugjerojnë një pozicion aktiv të të miturit në çdo proces, i cilësdo natyrë, kur bëhet fjalë për vendimmarrje që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre. Këtë gjë mund ta shohim edhe në legjislacionin tonë dhe në shumë procese ligjore të natyrës kryesisht familjare, civile etj. E drejta e pjesëmarrjes në proces përmban në vetvete disa aspekte procedurale që do i cekim në mënyrë të përmbledhur në vijim, por ajo çka vlerësoj se është e rëndësishme të konstatohet paraprakisht është se kjo e drejtë mund të ushtrohet drejtpërdrejtë nga i mituri ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor. Ndër aspektet procedurale të saj, është që në përputhje me të, i mituri ka të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij. Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij pranohet, përveçse për arsye të rëndësishme, të cilat arsyetohen në vendimin përkatës (KDPM-ja, neni 16/1). I mituri, drejtpërdrejt dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, ka të drejtë të marrë pjesë në çdo proces vendimmarrjeje lidhur me të. Çdo veprim i ndërmarrë nga organet kompetente gjatë procesit ku i mituri është pjesëmarrës, kryhet në mënyrë të përshtatur me moshën dhe/ose aftësitë e të miturit për të kuptuar. Në rast se pretendimet e të miturit dhe të përfaqësuesit ligjor/procedural të tij janë kontradiktore, organi kompetent vlerëson pretendimin që i shërben interesit më të lartë të të miturit (KDPM-ja, neni 16 pikat 2,5 dhe 7). Këto të drejta me natyrë procedurale detajohen më tej në Kreun V të KDPM, ku përcaktohen specifikisht rregulla për njoftimin, informimin dhe pyetjen e të miturit viktimë apo dëshmitarë i veprës penale.

4.2 Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut

Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut në pyetjen e të miturit viktimë/dëshmitar të veprës penale, pavarësisht nga mosha e të miturit nën apo mbi 14 vjeç, është një tjetër normë me karakter procedural, por jo vetëm. Ligjvënësi i ka kushtuar një vëmendje të posaçme rolit të psikologut në raport me të miturin viktimë/dëshmitar të veprës penale, përveç rëndësisë procedurale që ka pjesëmarrja e psikologut në aktet dhe veprimet procedurale që mbahen apo kryhen me të miturit. Psikologu garanton, sipas rastit, mbështetjen psikologjike të të miturit dhe vlerëson thëniet e tij, në përputhje me zhvillimin mendor. Prania e psikologut synon që të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi. Organet kompetente, sipas rastit dhe nëse kjo është e mundur, kujdesen që të sigurojnë praninë e të njëjtit psikolog gjatë gjithë procesit të drejtësisë penale për mitur dhe vetëm nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit (KDPM-ja, neni 18, pika 2, 3 dhe 4). Megjithatë, duhet kuptuar se përgjatë të gjithë procesit penal, pavarësisht natyrës së veprimeve procedurale të kryera nga organet proceduese, ndihma psikologjike (ashtu si edhe ndihma ligjore) për të miturin viktimë përbën një të drejtë me rëndësi jo vetëm për trajtimin adekuat të të miturit, por edhe për garantimin e një procesi ligjor normal. Theksi vihet kryesisht te veprimi procedural i pyetjes së të miturit viktimë, për shkak të rëndësisë

që paraqet ky veprim në tërësinë e procesit penal, por në fakt trajtimi psikologjik i të miturit viktimë duhet të jetë i vazhdueshëm, madje mund të jetë e nevojshme edhe tej procesit penal. Në këtë kuptim, neni 20 i KDPM-së përfaqëson një normë me karakter të përgjithshëm dhe nuk i drejtohet vetëm organeve proceduese, por çdo organi apo organizate që merret me trajtimin e rastit të një të mituri viktimë e veprës penale. Vlerësojmë se i njëjti arsyetim është i vlefshëm edhe në rastin e ndihmës ligjore, e cila është më e gjerë se thjesht dhe vetëm përfaqësimi me mbrojtës gjatë procesit penal. Ndihma psikologjike dhe ligjore jepet për të miturit pa pagesë dhe kjo dispozitë vlerësojmë se duhet të interpretohet sistematikisht edhe me nenin 23 të KDPM-së, ku parashikohet se të miturit në konflikt me ligjin ose viktimia përfitojnë pa pagesë shërbimet që ofrohen sipas këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi. Siç rezulton, të njëjtat të drejta duket se nuk zbatohen për dëshmitarët e mitur. Kjo normë ka bërë një diferencim ndërmjet të miturit viktimë e veprës penale dhe të miturit dëshmitar lidhur me përfitimin e ndihmës psikologjike (dhe ligjore). Ndërsa, e drejta për ndihmë psikologjike pa pagesë për të miturin viktimë nuk kushtëzohet nga ndonjë rrethanë, përveç faktit të atribuimit të pozitës së viktimës së veprës penale, për dëshmitarin e mitur, ndihma psikologjike pa pagesë akordohet *kur është e nevojshme*, rrethanë e cila është në vlerësimin e organit procedues.

4.3 E drejta për jetë private

E drejta e të miturit për jetë private, e parashikuar në nenin 21 të KDPM është një tjetër e drejtë e rëndësishme për të dy kategoritë e të miturve. Kuptimi i konceptit jetë private në kuadër të të miturve nuk rezulton në përmbajtjen e dispozitës, megjithatë në gjykimin tonë si referencë për përmbajtjen e këtij koncepti shërben kushtetuta dhe, veçanërisht KEDNJ-ja në nenin 8 të saj. Jeta private e një të mituri përfshin çdo gjë personale që tregon se si i kryen veprimet e nevojat e përditshme emocionale, fizike, anatomike, njerëzore, personale e familjare. Këtu përfshihen edhe të dhëna që lidhen me problematikat, veset apo veprimet e paligjshme ku ai është përfshirë si dëshmitar, viktimë apo i akuzuar për kryerjen e saj. Këto ndodhi, ngjarje, dokumenta, fotografi, video, akte administrative, vendime gjyqësore, procesverbale e intervista, të dhëna ose fakte duhet të konsiderohen si të klasifikuara për tu ndaluar që të bëhen publike me qëllim që të mbrohet sa më shumë jeta e ardhshme e një të mituri, madje edhe pasi i mituri të jetë bërë juridikisht i rritur me arritjen e moshës së kërkuar ligjore (Semini, Marjana, nd). Ligjvënësi e ka shtrirë mbrojtjen e jetës private të të miturit në çdo fazë të drejtësisë penale, që nënkupton që prej momentit fillestar kur organet përkatëse administrative apo ato proceduese vihen në kontakt me të miturin deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit apo masave të tjera ligjore. Kjo është një e drejtë, e cila duhet të respektohet e zbatohet kryesisht prej organeve apo institucioneve që janë në kontakt me të miturin dhe nuk është e nevojshme që i mituri të paraqesë ndonjë kërkesë për mbrojtjen apo respektimin e saj. Vlerësojmë se kjo dispozitë duhet të interpretohet në korrelacion edhe me nenin 43 të KDPM-së, i cili nga përmbajtja e tij rezulton se i referohet masave konkrete mbrojtëse të jetës private dhe mirëqënies së të miturit viktimë ose dëshmitar përgjatë ose në përfundim të procesit gjyqësor. Ato janë më të gjera se thjesht dhe vetëm mbrojtja e jetës private të të miturit viktimë ose dëshmitar, por i shërbejnë dhe garantimit të një procesi gjyqësor të drejtë, duke respektuar të drejtat

e viktimës, por njëkohësisht edhe të drejtat e të pandehurit.

4.4 E drejta për t'u informuar

E drejta e të miturit viktimë e veprës penale për t'u informuar përbën një të drejtë të rëndësishme, veçanërisht për aspektet procedurale të procesit penal. Në nenin 34 të KDPM-së ku parashikohet kjo e drejtë, fillimisht përcaktohen subjektet që janë pjesëmarrës në veprimet procedurale me të miturit viktimë, konkretisht përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi dhe psikologu, si dhe, sipas rastit, nëse është e mundshme, edhe personi i besuar i të miturit. Kjo dispozitë duket sikur lidhet me të miturin viktimë, por nisur nga fakti që viktima në shumë raste është edhe dëshmitar ky nen synon në garantimin e të drejtës së informimit të të miturit në pozicionin e viktimës dhe të dëshmitarit (Kombi, Elina, nd). Në dispozitë janë listuar një sërë çështjesh, për të cilat organet kompetente kanë detyrimin e informimit të menjëhershëm të të miturit dhe gjatë të gjithë procesit. Detyrimi për informimin duhet të përmbushet paralelisht edhe ndaj përfaqësuesit ligjor ose procedural, si edhe mbrojtësit të të miturit. Nëse i referohemi përmbajtjes së çështjeve për të cilat informimi është i detyrueshëm, shohim që ato janë kompetencë e një sërë organesh, pra jo vetëm ato proceduese, si prokuroria e gjykata, por edhe policia, njësitë e mbrojtjes së të drejtave të të miturve në institucione vendore etj. Madje, vetë dispozita parashikon që nëse informimi nuk i është bërë drejtpërdrejtë të miturit, atëherë ky detyrim përmbushet sipas rastit nga përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi procedural ose mbrojtësi. Duhet theksuar se informimi për këto çështje duhet të kryhet kryesisht nga organet përkatëse kompetente. Në nenin 35 të KDPM janë parashikuar detyrimet e Njësisë së Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, të cilat zbërthejnë disa prej detyrimeve të parashikuara në nenin 34 dhe disa të tjera janë masa me karakter psiko-social. Në vijim, në nenin 34 përcaktohen disa çështje, informimi i të cilave nga organi kompetent bëhet mbi bazën e kërkesës së përfaqësuesit ligjor. Gjykoj se kjo dispozitë duhet zbatuar në përputhje me nenin 38 të KDPM-së, e cila rregullon aspektet procedurale të njoftimit të të miturve, si mënyra e kryerjes së njoftimit, përmbajtja e njoftimit, subjekteve që u drejtohet etj., megjithatë, duhet mbajtur në konsideratë se në këtë fundit ligjvënësi u është drejtuar vetëm organeve proceduese, pra, jo çdo institucioni që ka lidhje me trajtimin e të miturve viktimë, por vetëm gjykatës dhe prokurorisë. Në nenin 34 të KDPM-së çështja që vlerësojmë se paraqet interes nga pikëpamja procedurale, por me implikime të rëndësishme në praktikën gjyqësore ka të bëjë me ushtrimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimit të gjykatës. Në pikën 4 të nenit 34 të KDPM-së parashikohet, ndër të tjera, se: *“Në çdo fazë të procesit, përfaqësuesi ligjor i një dëshmitari/viktimitë të mitur ka të drejtë: d) të bëjë ankim në lidhje me vendimin e dhënë nga gjykata, pavarësisht nëse kjo e drejtë ushtrohet ose jo nga prokurori i çështjes.* Aktualisht, mbetet për t'u parë në vijim në praktikën gjyqësore, duke qenë se ndryshimet ligjore të K.Pr.Penale dhe KDMP-ja, ende janë në hapat e parë të zbatimit të tyre dhe nuk ka praktikë të konsoliduar të gjykatave më të larta, se si do të interpretohet shtrirja e së drejtës për ankim të vendimeve të gjyqësore nga viktima e veprës penale. Nëse i referohemi K.Pr.Penale, konkretisht nenit 422 të këtij kodi, rezulton se nuk është parashikuar viktima ose përfaqësuesi i tij si subjekt që mund të ankimojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, por janë përcaktuar subjektet e tjera të procesit penal si prokurori, i pandehur, paditësi

civil dhe i padituri civil. Lidhur me raportin ndërmjet dy legjislacioneve, KDPM-ja parashikon se dispozitat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjeve të tjera, zbatohen në procesin e drejtësisë penale për të mitur vetëm për çështje që nuk janë të rregulluara nga ky Kod ose nëse përmbajnë rregullime më të favorshme për të miturit (KDPM, neni 5).

4.5 E drejta e mbrojtjes

E drejta e mbrojtjes së të miturit viktimë përbën ndoshta garancinë më të rëndësishme të implementuar në procesin penal, krahasuar me parashikimet e mëparshme të procedurës penale. Ligji procedural penal, përpara reformës së viti 2017, nuk kishte parashikime lidhur me të drejtën e mbrojtjes së viktimës. Edhe personi i pazotë për të vepruar nuk mbrohej nëpërmjet mbrojtësit, por dispozita parashikonte se personi i dëmtuar që nuk ka zotësi juridike për të vepruar i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij (K.Pr.P-ja, neni 58/2, viti 2014). Aktualisht, ligji procedural penal parashikon se viktima e veprës penale (jo i mitur) ka të drejtën të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi. Për të miturin viktimë, KDPM-ja parashikon se i mituri viktimë ka të drejtë të mbrohet pa pagesë gjatë gjithë procesit të drejtësisë nga një avokat, të cilin e zgjedh nga lista përkatëse e hartuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Është i qartë diferencimi në trajtim sa i përket të drejtës për mbrojtës për kategorinë e viktimave në përgjithësi dhe kategorisë së të miturve viktimë në veçanti, ku për këta të fundit, mbrojtja me avokat është pa pagesë. Diskutimi që mund të lindë në praktikën gjyqësore lidhur me mbrojtjen me avokat për të miturin viktimë, është nëse ka ose jo karakter të detyrueshëm, porë kjo në kontekstin edhe të dispozitave të tjera të KDPM-të trajtuara më lart. Në kushtet e mungesës së praktikës gjyqësore shqiptare, por edhe karakterit disi të paqartë të dispozitave të KDPM-së për këtë çështje, mund të ketë disa qendrimë. Një qendrim është ai, që prirem ta mbështes, se në çdo rrethanë mbrojtjen me avokat të të miturit viktimë e konsideron të detyrueshme (psh. kjo duket se rezulton në nenin 34, 36 të KDPM-së), një qendrim tjetër mund të jetë që mbrojtja me avokat për këtë kategori nuk është detyrueshme, pasi gjithsesi pozita e të miturit viktimë nuk mund të barazohet tërësisht me atë të të miturit në konflikt me ligjin dhe ligji shprehet për mbrojtjen si një e drejtë dhe jo si detyrim, si edhe një qendrim i tretë që e lidh detyrueshmërinë e mbrojtjes me ekzistencën e disa rrethanave si kërkesa e të miturit ose përfaqësuesit të tij, mungesa e familjarëve ose njerëzve të afërt/besuar etj.

4.6 Masat mbrojtëse të sigurisë

KDPM-ja parashikon në kuadrin e sigurisë së të miturit viktimë ose dëshmitar, disa masa të quajtura masa mbrojtëse, të cilat përbëjnë risi për legjislacionin penal shqiptar për mënyrën se si janë konceptuar llojet e tyre dhe procedurën që ndiqet për zbatimin e tyre, e cila paraqet ndryshime në raport me procedurën tradicionale që parashikohet në K.Pr.Penale. Ajo çka duhet të thuhet është se këto masa mbrojtëse, që parashikohen në nenin 37 të KDPM, nuk përbëjnë një listë shteruese, por ligjvënësi e ka lënë të hapur mundësinë për të caktuar/zbatuar masa të tjera që janë të përshtatshme. Kjo do të thotë që përshtatshmëria e tyre do të vlerësohet sipas rastiit nga organet përkatëse kompetente që vijnë në kontakt me të miturin viktimë ose dëshmitar. Një

masë mbrojtëse, që parashikohet në nenin 37 të këtij kodi, e cila gjykojmë se paraqet interes është masa e quajtur urdhër-kufizimi. Lidhur me këtë masë, kjo dispozitë ka referuar te legjislacioni përkatës për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Me këtë nënkuptohet se kjo masë ka karakter të ngjashëm me masat që merren ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, për sa i përket detyrimeve që i vendosen të paditurit nëpërmjet urdhrut të mbrojtjes, si edhe sa i përket procedurës që ndiqet ku kërkesa parashtrohet nga prokurori, policia gjyqësore apo njësia e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, gjykojmë se një kërkesë e tillë nuk duhet të ketë ndalim edhe nëse paraqitet nga i mituri apo përfaqësuesi i tij, për sa kohë referimi për caktimin e kësaj mase bëhet edhe te legjislacioni për masat ndaj dhunës në familje. Me interes, gjithashtu, është parashikimi si masë mbrojtëse e paraqitjes së kërkesës nga prokuroria për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg apo arrest shtëpie për të akuzuarin. Në këtë pjesë të dispozitës nuk është parashikuar, por në këtë rast çështja e rrezikimit të sigurisë së të miturit, përbën një nga kushtet e posaçme për caktimin e masave të sigurimit, sipas legjislacionit procedural që njihet si rreziku për kryerjen e veprave penale njësoj të rënda apo më të rënda me atë që është kryer. Ligji ka parashikuar më tej risinë, që masa e urdhër-kufizimit dhe masa e sigurimit (arrest në burg/shtëpie) merren kryesisht edhe prej gjykatës, pra, pa pasur kërkesë nga subjektet përkatëse. Pavarësisht, se veçanërisht sa i përket masës së sigurimit, bëhet fjalë për ndryshim nga rregullat tradicionale të procedurës penale, gjykojmë se jemi përpara prevalencës së parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

4.7 Pyetja e të miturve viktimë/dëshmitar të veprës penale

Në nenin 39 të KDPM-së parashikohen rregulla të përgjithshme për marrjen në pyetje të të miturve viktimë dhe/ose dëshmitarë të veprës penale. Këto rregulla i referohen të gjithë kategorisë së të miturve viktimë apo dëshmitarë, por në dispozitat në vijim, ligjvënësi ka parashikuar edhe dispozita të tjera të posaçme për disa nënkategori të miturish viktimë si ata nën moshën 14 vjeç, ata të moshës 14-18 vjeç dhe ata që janë viktimë e dhunës apo shfrytëzimit seksual. Sa i përket rregullave të përgjithshme përcaktohet se organet kompetente sigurojnë shmangien, në çdo rast, të përbaljes së të miturit viktimë me të akuzuarin në të gjitha mjediset ku zhvillohet procesi. Në rastet me të mitur viktimë ose dëshmitarë, zhvillimi i seancës gjyqësore bëhet vetëm me dyer të mbyllura. Pyetja e të miturit viktimë dhe dëshmitar zhvillohen pa vonesë pas raportimit të fakteve tek organet përkatëse. Pyetja e të miturit kryhet në mjedisë miqësore për ta, si edhe jashtë mjedisit të gjykatës; sigurimi i proves realizohet në një kohë sa më të shkurtër pas fillimit të procedimit penal, për të shmangur efektet negative që vijnë nga tejzgjatja e procesit; mosrimarrjen në pyetje të të miturit viktimë ose dëshmitar në shkallët e tjera të gjykimit për të shmangur riviktimizimin e të miturit, me përjashtim të rasteve të caktuara në ligj; çdo masë tjetër që gjykata i konsideron të përshtatshme. Të njëjtat rregulla zbatohen nga organet e tjera kompetente edhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë dhe dëshmitar. Në rastin kur dhënia e dëshmisë mund ta vendosë viktimën ose dëshmitarin e mitur në rrezik serioz për jetën apo për shëndetin, gjyqtari, në përshtatje me moshën, gjatë gjykimit garanton që pyetja e dëshmitarit/viktimë të mitur të kryhet duke përdorur pajisje që ndryshojnë pamjen dhe/ose zërin e dëshmitarit/viktimës, marrjen e tij në pyetje pas një ekrani jotransparent ose marrjen në pyetje në distancë; pyetjen e

Në vitin 1407 në Gjenovë themelohet banka e parë, Casa di San Giorgio. Ajo ishte bankë në kuptimin e plotë. Kjo bankë dispononte me shuma të mëdha mjetesh monetare, pranja jepte hua të shumta, si dhe kryente qarkullimin e pagesave në mes të qendrave tregtare. Bankat shtetërore të Venedikut (Republikës së Venedikut) ishin: Bancko di Rialto (1587. – 1617.) dhe Banco del Giro (1617. – 1806.). Në Italinë Veriore në shekullin XIII për herë të parë përdoret edhe kambiali, mjet ky i rëndësishëm i afarizimit dhe i kreditimit.

Me zhvillimin e rrugëve të reja të tregtisë tejdetare dhe me përparimin e navigacionit në shekullin XV., XVI. e XVII., gradualisht u bart qendra e tregtisë botërore nga Mediterani (Mesdheu) – regjioni i Mesdheut, në Europën Veriore e Perëndimore, ku afarizimi bankar zuri vend primar. Gjatë kësaj peridudhe u mbollën farët e revolucionit industrial, prandaj edhe u shfaq nevoja për themelimin e një sistemi të zhvilluar financiar. Përveç kësaj, konstruktimi i makines me avull dhe paraqitja e prodhimit masiv, parashtrroi nevojën e ekspansionit përkatës të tregut global, në mënyrë që të apsorbojë prodhimin industrial, si dhe metodave të reja për kryerjen e pagesave dhe dhënien e kredive. Bankat që arriten tu përgjigjen këtyre kërkesave të reja, përparuan shumë shpëjt, të udhëhëqura nga institucionet si Medici Banka në Itali e Hochstetter Banka në Gjermani.

Pas zbulimit të kolonive në Amerikën Veriore e Jugore, praktika bankare e Botës së Vjetër u bart edhe në Botën e Re. Në fillim kolonizatorët punonin kryesisht me bankat e atyre vendeve, prej nga kishin ardhur, kurse në fillim të shekullit XIX. edhe në Amerikë filluan të themelohen bankat e para.

Shekulli XVII. ka rëndësi shume të madhe për zhvillimin e bankave ngase në këtë periudhë, me organizimin dhe afarizmin e tyre, ato u afrohen bankave bahskëkohore. Në këtë kohë themelohen xhiro – bankat në Venedik, Gjenovë, Hamburg e qytete të tjera, të cilat kryenin pagesat pa para të gatshme, duke bartur mjetet nga një llogari në tjetrën dhe këtu e hasim zanafilën e kliringut dhe të mënyrës së pagesës me ane të virmanit. Banka e Amsterdemit, Wisselbanka, e cila u themelua më 1609., futi para të veçantë bankare, kurse në Gjermani këtë e bëri xhiro – banka e Hamburgut (1619. – 1875.). Paratë e kesaj banke (të ashtuquajturat Mark – Banco = 8 ½ të argjendit të pastër), vlenin në pjesën më të madhe të Europës.

Ringjallja ekonomike, e cila fillon në Europë pas zbulimit të Amerikës, kërkon shumë më tepër kredi dhe kështu paraqitet surrogati i parasë – bankënota. Në vitin 1694. themelohet në Angli Bank of England sipas planit të skotlandezit, William Peterson, dhe kjo bankë konsiderohet si bankë e parë emisionare moderne në historinë bankare. Në Francë, banka e parë ishte Banque Generale, të cilën e themeloi në

vitin 1716. skotlandezi John Laë. Kjo bankë bëri emisionin e bankënotave dhe u dha kredi përsoneve privatë dhe shtetit. Mirëpo, për shkak të emisionit të tepruar të bankënotave, kjo bankë u shua në vitin 1720., duke shkaktuar çrregullime të medha financiare në Francë. Në vitin 1800. themelohet Banque de France. Kjo ishte Bankë Qendrore dhe atë e themeloi Napoleoni për financimin e luftërave.

Bankat emetuese të Anglisë dhe Francës kanë ushtruar ndikim shumë të madh në themelimin e bankave të tjera emetuese në shqekullin XVIII. e XIX. në vendet e ndryshme të botës.

Në shqekullin XVIII. themelohen një varg institucionesh bankare të karakterit privat e publik, mirëpo të gjitha këto u likuduan pas një kohe të shkurtër. Banka e vetme që ka mbetur nga ajo kohë, është Bank of England.

Në shqekullin XIX. fillojnë të themelohen bankat aksionare, të cilat me ndryshojnë rolin e deiratëhershëm të huadhënësit dhe ndërmjetësuesit për qarkullimin e pagesave, kurse disponojnë kapital të madh, i cili është krijuar në procesin e koncentrimin të bankave dhe të koncentrimin të shumave të mësha të mjeteve të huaja. Zhvillimi i mëtejshëm i bankave dhe lidhja më e ngushtë e kompanive industriale e bankare, ndikuan mbi tendencat e shtuara të koncentrimin të kapitalit monetar dhe në monopolizimin e bankave.

Më parë bankat kanë qenë krijuesit e vetme të likuiditetit dhe bartëset e funksionit depozitar. Mirëpo, me zhvillimin e ekonomisë bashkëkohore, krijohen një mori organizatash të tjera financiare, të cilat, krahas me bankat luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e mobilizimit të mjeteve monetare dhe financimit të nevojave të ekonomisë. Disa nga këto institucione punojnë në një fushë të ngushtë të aktivitetit financiar. Në kusht bashkëkohore, e sidomos në vendet ekonomikisht të zhvilluara hasim një numër të madh institucionesh financiare private, të cilat, për nga përmbajtja e punës së tyre, nuk mund të quhen banka. Pikërisht për këtë arsye duhet përcaktuar në mënyre sa më të qartë definicionin e bankës në mënyre që të shihet dallimi në mes të bankave dhe organizatave të tjera financiare.

2. Historiku i industrisë bankare në Kosovë

Njerëzit në Kosovë janë ballafaquar me diskriminim të vazhdueshëm ekonomik dhe social gjatë viteve 1990, një dekadë që përfundoi në luftë në vitin 1999. Ekonomia e pasluftës u shënuar nga papunësia e lartë dhe vendit i mungonte stabiliteti social dhe politik. Ajo ishte e nevojshme për të siguruar përforcimin e sektorit privat si dhe për të promovuar, zhvillimit socioal ekonomik të Kosovës. Sektori privat varej nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ndërmarrjet e (NVM), të cilat mund të gjenerojnë punësim, forcimin e ekonomisë dhe përmirësimin e jetës sociale të kosovarëve. Megjithatë, ka pasur një mungesë të kapitalit investues dhe politikat që bëjnë mbështetjen e sektorit privat dhe Kosova nuk ka pasur bankën e vet.

Bazuar në përvojat e financimit mikro në Bosnje dhe Shqipëri, sipërmarrja e bankave të vogla në Kosovë (MEB Kosovë) është themeluar në vitin 1999. për të siguruar kredi të vogla bizneset, si dhe aktivitetet e zakonshme bankare. MEB e ka ndihmuar Kosovën të gjenerojë punësimin dhe të ardhurat me anë të shërbimeve të saj dhe ka përfshirë popullatën lokale në mesin stafit të saj. Nga 2002., MEB kishte disbursuar 47 milion € (rreth US \$ 44.3 milion) deri 6,800 kreditë për ndërmarrjet mikro dhe

të vogla. MEB njerëzve të zakonshëm në Kosovë ka bërë mbështjen e jetës së tyre me mjetet dhe u bë një burim i besueshëm i orientuar në kredinë komerciale dhe shërbime të tjera financiare për bizneset mikro dhe të vogla.

Ekonomiadhemënyraejetëskosovarejanëgoditurrëndëngalufutanëvitin1999.Nëatëvit, vlerësuar produkti i brendshëm bruto i Kosovës (GDP) ishte US \$ 1-1500000000 dhe shkalla e papunësisë fluturoi rreth 74 për qind (shifrat UNDP). Kështu, përveç sigurimit të paqes, ka pasur një nevojë për të gjeneruar të ardhura, të krijojë punësim dhe të rris eksportet për rimëkëmbjen ekonomike dhe rritjen e qëndrueshme; këto mund të bëhen duke u forcuar sektori privat.

Gjatë viteve 1990., kontributi i sektorit privat në ekonominë e përgjithshme të Kosovës ishte duke u përmirësuar, dhe ndarjen e ndërmarrjeve private në GDP e vendit është rritur nga 47 për qind në vitin 1996. në 80 për qind në vitin 1998. Megjithatë, paqëndrueshmëria politike pas konfliktit të vitit 1999. është bërë e vështirë për të tërhequr investimet e konsiderueshme të huaja dhe për të inkurajuar një sektor në shkallë të industrisë (veçanërisht bizneset me më shumë se 250 të punësuar), kur vetëm 58 nga 156 të ndërmarrjeve në publik kanë operuar.

Kosova nuk kishte banka të veta pas konfliktit. Micro Enterprise Bank e Kosovës është themeluar në fund të vitit 1999. si një iniciativë e përbashkët e International Finance Corporation (IFC), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), dhe firmat gjermane Internationale e projektit Consult (IPC). MEB Kosova kishte për qëllim përmirësimin e gjenerimit të punësimit dhe të ardhurave nëpërmjet mikrokredive për ndërmarrjet mikro dhe NVM. Dega e parë e MEB Kosovës u hap me seli në Prishtinë pranë UNMIK-ut (United Misioni i Kombeve “në Kosovë), me financim të konsiderueshëm nga holandezët dhe qeveritë gjermane. Në janar të vitit 2000., me një bazë të kapitalit fillestar prej US \$2 milionë, MEB Kosova u bë banka e parë në Kosovën e pasluftës për të marrë një licencë bankare nga BPA (Bankar dhe i Pagesave i Kosovës).

Banka mikro të kreditimit është një nga dhjetërat që operojnë në zonat e varfra rreth bota. MEB Kosova ofron shërbime si menaxhimin e llogarisë, të këmbimit valutor, transfertat e parave, si dhe kreditë dhe transaksionet për ndërmarrjet e vogla ose konsumatorët individual, dhe punon (si më poshtë) për të:

- Të sigurojë një disponueshmërinë më një rritje të kreditimit si një gamë të gjerë që është e mundur të NVM-ve
- Arritja e kredisë dhe shlyerjes së norma të larta të interesit në mënyrë që të sigurojnë flukse të vazhdueshme të Fondet për kreditimin e NVM
- Përforcojnë reformat e fundit në sektorin financiar të paraqitura nga UNMIK-u për të ndihmuar në ri - krijimin e kapaciteteve të menaxhimit të kreditit dhe të administrimit të aftësisë themelore të kredisë të sapo dalura nga bankat, dhe për të ndihmuar SME-në që të rritin disiplinën financiare dhe planifikimin e kapaciteteve përmes procesit të kredisë.²

I nisur nga asgjëja, sistemi bankar i Kosovës sot mund të mburret me themelet e vëna dhe këtë ecje të vogël ndër vite, por mjaft të qëndrueshme. Trembëdhjetë vjet më parë, ai ballafaqohej me ankthin më të tmerrshëm që një sistem mund ta kishte, humbjen e besimit. Kosovarët, herën e fundit që bashkëvepronin me bankat, kishin humbur të gjitha kursimet dhe çdo kthim në këtë sistem, domosdo kërkonte

² http://siteresources.worldbank.org/INTEMPowerment/Resources/14830_Kosovo-web.pdf

një paraqitje e bindje përtej të zakonshmes. Trembëdhjetë vjet më pas, mosbesimi në sistemin bankar është i rrallë. Për më tepër, bankat kosovare janë bërë strofull i mijëra të punësuarve, shembull i një menaxhimi modern, atraksion i karrieristëve bankarë dhe fascilitator i krijimit të një industrie të tërë përcjellëse, në shërbim të gjithë sistemit. Të tri fushat fatkeqësisht burojnë mu nga aktorët e interaksionit: bizneset, bankat dhe vetë shteti. Sektori Bankar, si një ndër sektorët më të zhvilluar dhe më të qëndrueshëm në Kosovë, mund të thuhet se paraqet një ndër tregimet më të suksesshme në Kosovën e pasluftës.³

Sistemi i Rrjetit bankar i Republikës së Kosovës është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme që kur vendi shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008. Rrjeti bankar i vendit ishte shkatërruar gjatë luftës së Kosovës. Si një vend i ri Kosova ka kaluar nëpër ndërtimin e institucioneve shtetërore dhe reformat publike. Rrjeti i sistemit bankar në vend është zhvilluar nga zeroja.

Sistemi i Rrjetit bankar të Kosovës është një rrjet informal dhe kompleks në një kuptim që siguron rrjedhën e transaksioneve financiare dhe stabilitetin makroekonomik në vend, duke përfshirë Bankën Qendrore dhe institucionet e tjera mikrofinanciare. Qendër kryesore e rrjetit është konsideruar të jetë Banka Qendrore e Kosovës (BQK), e cila është një pasues i Pagesave të Autoritetit Bankar dhe të Kosovës e themeluar në qershor të vitit 2008. Ai është një person juridik i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës. Banka Qendrore është konsideruar si një pikë qendrore për shkak se të gjitha institucionet e tjera mikrofinanciare janë të lidhura me Bankën Qendrore dhe janë nën mbikëqyrjen e tij.⁴

Gjatë viteve 1990, shumica e bankave transferuar monedhën e vështirë për Serbinë apo për disa nga industritë shoqërore / shtetërore në Kosovë. Pastaj shqiptarët dhe menaxherët e tjerë jo-serbë dhe punëtorët u pushuan nga këto industri për të lehtësuar punësimin e serbëve etnikë. Si këto kompani filloi të përkeqësohej fizikisht dhe transferimet e burimeve në Serbi u bënë më pak të shpeshta, bankat e mbetura lënë në tregun e Kosovës. Ky model në sektorin bankar - së bashku me likuidimin ligjore në tentativë të Bankës Kos3 - u bë homologu financiare e de-industrializimit të Kosovës pas revokimit të statusit të saj si një krahinë autonome.

Para konfliktit të vitit 1999, Kosova kishte pesë banka të mëdha dhe thuhet se 54 degë të bankës, 4 prej tyre janë serbe. Megjithatë, asetet, kreditë, depozitat, kapitalit, dhe të tjera të dhëna në përgjithësi standarde bilancit bankar megjithatë nuk janë të raportuara - me përjashtim të autokton Ekonomik të Bankës, një pasardhës i Bankës Kos-3 të mbyllur. Nëse matet me standardet e raportimit gjenden në zona të tjera tregues ekonomikë, këto të dhëna do të ishin të pakuptimta edhe nëse reportohen. Kjo është për shkak se aktivet dhe kreditë nuk pasqyrojnë humbje në sigurimin ose shkruan të humbura siç është e zakonshme në praktikën ndërkombëtare. Depozitat do të kishte reflektuar depozitat valutore të ngritura prej rreth US \$1 miliard (transferuar në Beograd në vitin 1990.)

Nga të katër bankave të mëdha që operojnë para luftimeve, janë raportuar tre të veprojnë deri në fund të vitit 1998 / fillim të vitit 1999, edhe pse vetëm në mënyrë të kufizuar:

- Bank Kos, i cili është çaktivizuar në vitin 1990, por ka shërbyer ndërmarrjeve

³ <http://bankassoc-kos.com/wp-content/uploads/2012/07/The-Kosovo-Banker-Botimi-I.pdf>

⁴ "Banking System in Kosovo". Economic Initiative for Kosovo. Retrieved 24 May 2013.

të mëdha industriale dhe agro-kombinate nga 1961 për çaktivizimin e saj - të ngjashme me rolin e luajtur nga Privredna Banka e vjetër në ish-Jugosllavi në Bosnje-Hercegovinë sot dhe Kroacisë.

- *Beobanka*

- Banka Ekonomike, e cili zëvendësoi Banka Kos në Kosovë sa i përket klientelës së përgjithshme të synuar dhe ende ka infrastrukturën bazë operacionale. Nxjerrje e vazhdueshme të aseteve, pajisjeve, transferimet e fondeve, dhe shkarkimet e shqiptarëve etnikë nga ndërmarrjet industriale - të gjitha dhënë aktivitetet e bankës gjithnjë e më pak i rëndësishëm gjatë viteve 1990. Nga fundi i vitit 1999, Banka Ekonomike thuhet se kishte vetëm rreth 7 Dinar deri në 8 milionë euro në depozita (rreth 500.000 DM, apo më pak se US \$ 300,000).

- Jugobanka, e cila vepronte në të gjithë Jugosllavinë para saj shpërbërjes, dhe ende vepron në Serbi, edhe pse ajo tani është e vdekur në Kosovë.

- Vojvodjanska Banka, e cila, si Banka Ekonomike, posedon një infrastrukturë për operacionet bazë të pagesës, por tani është e mbyllur.

Ashtu si në pjesën tjetër të vendit, sipas modelit të "pronësisë shoqërore," këto banka tradicionalisht kanë shërbyer si rob të kompanive të financave. Ata huazuan të holla prej pronarëve të tyre në ndërmarrjet nën pronësi shoqërore dhe ofrojnë shërbime të shumta për punonjësit e tyre përkatëse. Këto depozita përfshinë pranimin e pagesave të pensioneve dhe sigurimin e funksione të tjera themelore financiare. Drejtimi i sektorit privat dhe aksionarët janë shtuar në vitet 1990., edhe pse roli i tyre nuk ishte i rëndësishëm për shkak të informalizimit të ekonomisë.

Në përgjithësi, roli i këtyre bankave është zvogëluar në vitet 1990., se industria në Kosovë u bë gjithnjë e drejtuar poshtë, dhe shqiptarë dhe të tjerët gjeten punë në sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve (kryesisht në ekonominë e zezë). Degët e bankave nga Serbia që operojnë në treg në vitet 1990 funksiononte më tepër si banka njësi, dmth, pa ose disa degë. Objektivi i tyre kryesor ishte për të transferuar monedhën e vështirë nga Kosova në vaults në Beograd apo në llogaritë jashtë vendit. Shumica e këtyre bankave kishte mbyllur dhe u kthye në Serbi deri në fillim të vitit 1999.⁵

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) u themelua në vitin 2002. si organizatë joqeveritare me qëllim që të bashkojë të gjitha bankat komerciale që operojnë në Kosovë në një vend të vetëm dhe t'i përfaqësojë ato denjësisht. SHBK që nga fillimet e saj është angazhuar maksimalisht në lobim dhe avokim ku ka bashkëpunuar vazhdimisht me Bankën Qendrore, Qeverinë, Mediat dhe Opinionin Publik, Shoqatat dhe institucionet tjera në mënyrë që të promovohet sektori bankar dhe zhvillimi ekonomik afatgjatë i Kosovës.

SHBK ka koordinuar një numër të madh të projekteve për bankat, ndër të cilat janë:

- Regjistri i Kredive dhe Sistemi Ndërkombëtar i Raportimit të Transaksioneve
- Sistemi i Pagesave GIRO
- Skema e Debitimit Direkt

Këto ishin ndër projektet e para të cilat u koordinuan nga Shoqata e Bankave të Kosovës ku edhe u evidentua rëndësia e ekzistimit dhe punës së SHBK-së. Vlen të përmendet se SHBK është angazhuar edhe në procesin e rishikimit të rregullave bankare dhe si anëtare e grupeve punuese të qeverisë poashtu ka marrë pjesë në

⁵ http://ec.europa.eu/enlargement/archives/seerecon/kosovo/documents/wb_econ_report/ëeb-kosovo-econreport-vol2-ch3.htm

procesin e përpilimit të një numri të ligjeve.

Përveç rolit të lobimit dhe avokimit, SHBK poashtu është përkushtuar maksimalisht edhe në ofrimin e trajnimeve për stafin e bankave që operojnë në Kosovë. Si rrjedhojë e kësaj, është themeluar Qendra e Trajnimeve në vitin 2005. ku një numër shumë i madh i punonjësve të sektorit bankar është trajnuar. Këto trajnime në përgjithësi kanë ofruar kurse me fokus në banka dhe financa përmes së cilave edhe është zhvilluar kapitali njerëzor i bankave, përmes së cilit edhe bankat kanë përfituar mjaft sa i përket avantazhit të konkurrencës.

Shoqata e Bankave të Kosovës është anëtare e:

- Odës Ekonomike të Kosovës që nga viti 2006.
- Anëtare e Asociuar në Rrjetin Evropian të Trajnimeve Bankare (EBTN) që nga viti 2009

3. Sistemi Bankarë në Kosovë në ditët e sotme

Gjatë vitit 2010., Banka operuar 9 në territorin e Kosovës. Emetimet degëve gjeografike të këtyre bankave është e ndryshme për banka të ndryshme shpjegoi se fuqinë e investimeve të tyre, jetëgjatësi në treg, strategjitë që ndjekin në vitet e para të ekzistencës së tyre (për bankat e reja), etj.

Sistemi bankar kosovar është një sistem relativisht i ri, por që pas vitit 1999, ka shfaqur një zhvillim të shpejtë. Open Data Albania ka kryer një hulumtim mbi sistemin bankar në Kosovë, bazuar në të dhënat e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës. Shtrirjen më të madhe gjeografike e ProCredit Bank dhe Raiffeisen Bank, kjo bankë për shkak të potencialit që kanë. E konsiderueshme gjeografike gjithashtu duket për NLB, TEB, BpB, BE, BKT, ndërsa Banka Tregtare ka degët e saj në disa rrethe.

Aktualisht sistemi bankar përbëhet nga 9 banka:

Burimi: BQK

NR	EMRI	Pjesëmarrja në sistem	Origjina e Kapitalit
1	Banka Ekonomike	5%	Vendase
2	Banka për Biznes	4%	Vendase
3	Banka Kombëtare Tregtare	3%	E huaj
4	Procredit Bank	34%	E huaj
5	Raiffeisen Bank Kosovo	31%	E huaj
6	NLB Prishtina	15%	E huaj
7	TEB sh.a	6%	E huaj
8	Komercijalna Banka ad Beograd	1%	E huaj
9	Banka Përbashkët për Biznes	1%	E huaj

I gjithë sistemi bankar kosovar është i privatizuar, dhe pjesa më e madhe e kapitalit zotërohet nga entitete të huaja (6 nga 9 banka). Numri i bankave të huaja është rritur veçanërisht në 2008., kur u shtuan edhe 2 banka të reja. Gjithashtu bankat me kapital të huaj kanë edhe pjesën më të madhe të aktiveve të sistemit (rreth 90%), ndërkohë që bankat me kapital vendas zënë vetëm 10% të totalit të aktiveve.⁶

⁶ www.bqk-kos.org

Në vitin 2010, sistemi bankar është karakterizuar nga zgjerimi i infrastrukturës, numri i degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale arriti në 303, që paraqet një rritje vjetore prej 16 njësie.

Struktura e sistemit bankar në Kosovë në vitin 2010. ishte e ngjashme me atë të një viti më parë, pasi që numri i bankave, si dhe me strukturën e tyre të pronësisë. Në vitin 2012., tregu bankar në Kosovë është shtuar në një banke të re, rritjen e numrit të bankave komerciale në nëntë (9). Struktura e pronësisë së bankave ka mbetur e pandryshuar: 7 bankat e huaja dhe dy banka me pronësi vendore. Bankat e huaja kanë një pjesëmarrje prej 89.5 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar të vendit.

Në vitin 2012, bankat komerciale ka pasur një total prej 3,727 të punësuar, si dhe në vitin 2011., kur ata ishin 3,728. Ndërsa numri i degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale në vend arriti në 310 në vitin 2012., në krahasim me dy vjet më parë është rritur numri shtatë.

Sistemi bankar në Kosovë vazhdon të karakterizohet me një shkallë të lartë të koncentrimin të tregut, ku rreth 77.4 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar menaxhohen nga tri bankat më të mëdha. Dy bankat më të mëdha, ProCredit Bank dhe Raiffeisen Bank kanë një pjesë në tregun e kredisë me 68%.

Asnjë nga këto banka në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk ka pozitë dominuese që nuk e kalon kufirin prej 40% të tregut. Megjithatë, duhet theksuar se rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave më të vogla kanë ndikuar në shkallën e koncentrimin në tregun bankar ka vazhduar të bjerë nga viti i kaluar.

Përfundime

Kuptimi i bankës është shumë i lehtë për tu kuptuar ,shpesh barazohet me konceptin e ndërmarrjes kreditore ose institucionit monetar/ kreditor. Përdorimi i emrave të ndryshëm është problem më i vogël për kuptimin e konceptit të bankes, ngase zakonisht kemi të bëjmë me emra të ndryshëm për të njëjtin koncept. Emrat e ndryshëm rrjedhin nga praktika ligjdhënëse e vendeve të ndryshme, që është si rrjedhim i strukturës shoqërore – ekonomike e financiare, traditës, zhvillimit historik etj. Termat e tillë mund të përdoren krahas emrit bankë por nuk e përcaktojnë dot ende konceptin dhe definicionin e mirëfilltë të bankës. Pa institucionin e bankës do të ishte e pamundur kthimi i numërt të madhë të kursimeve të vogla të individëve dhe të kapitaleve likuide të lira, në fonde kolosale për financimin ose kreditimin e veprimtarive dhe projekteve që kanë nevojë për kapitale të mëdha suplementare.

Për të kuptuar industrinë bankre duhet të shikojmë historikun e industrisë bankare në Evropë dhe përkatësisht në Kosovë. Pikërisht zivillimi ekonomik i një vendi përcaktohet edhe nga evoluimi i sistemit bankare ,i cili po zhvillohet çdo ditë e më tepër si rezultat i zhvillimit edhe të teknologjisë elektronike.

Referencat

"Banking System Kosovo" Economic Initiative for Kosovo. Retrieved 24 May 2013.

Weninger, John. "The Emerging Role of Banks in E-Commerce." *Federal Reserve Bank of New York*. Wesley Longman, 1997.

Basel Commite on Banking Supervizion, Risk Management for Electronic mony Activites

Basle, Mart 1998.

Madura ,J.Internatijonal Financial Menagement 6 th Edition,South –Eëstern College Publishin 2000,Part III ,Risk Management ,Faqe 241.

Golijanin M., (1979) “Bankarstvo Jugoslavije – Teorija, organizacija I poslovanje”, Privredni pregled, Beograd, f. 20.

Komoni, S., (1985) “Financat”, Enti I teksteve dhe I mjeteve mësimore I KSA të Kosovës.

Ahmad,R., Ariff , M. And Skully, M.j. (2008):The Determinationsof Bank Capital Ratios in a Developing Economy ,Published in December 2008 by Asia –Pacific financial markets, vol.15.

BCBS (2010) :Basel III:International Framework for Liquidity Risk Measurement,Standards and Monitoring ,Basel Committe on Banking Supervision.

Richards Davies and Peter Richardson ,Evolution of the UK banking system , 2010.

Stile të Pikturës Murale Pasbizantine

Dr. Rozela Dhimgjini

Abstrakt

Arti Pasbizantin është një term që përdoret për të përshkruar artin ortodoks kristian, i cili u zhvillua pas Rënies së Kostantinopojës (1453) dhe shpërbërjes së Perandorisë Bizantine.

“Bota” ortodokse post-1453 mund të ndahet në tre sfera kryesore: në sferën Athonite, që përbëhet nga territoret ortodokse nën sundimin turk; sferën Veneciane, që përmban pushtimet venedikase në Mesdheun Lindor (ishujt jonian dhe cikladik); si dhe sferën periferike, që përbëhet kryesisht nga Rusia, Bullgaria, Serbia, Moldavia, Vallahia (pjesë e Rumanisë) dhe Gjeorgjia¹.

Për të kuptuar artin pasbizantin dhe ndikimin e tij në pikturën murale të kishave të Shqipërisë, duhet detyrimisht të trajtojmë dhe të njohim „linjat“ dhe “trendet” e pikturës murale pasbizantine, të cilat u ndikuan si nga “shkollat” artistike athonite ashtu dhe nga ato veneciane.

Fjale kyçe: Piktura Murale Pasbizantine, Venecia, Shqipëri.

Hyrje

Është e vështirë të shkruash mbi pikturën lindore pasbizantine, pasi ende nuk është ndërmarrë një studim i përgjithshëm artistik, ikonografik dhe stilistikor për këtë periudhë të rëndësishme historike dhe kulturore². Megjithatë vlen për t’u theksuar që në vitet e fundit janë shtuar studime të shkëputura mbi pikturën e një ndërtimi fetar, e një zone të kufizuar, të një piktori apo të një grupi artistik, duke përcjellë tendenca (megjithëse të pjesshme e të shkëputura) stilistikore dhe ikonografike të një segmenti artistik³. Kjo na ndihmon në studimin dhe përcaktimin më të saktë të rrymave krye-

¹ TURNER 2003, 329.

² Një vështrim kritik mbi artin pasbizantin grek shkruan T. GOUMA PERTERSON, *The Survival of Byzantinism in 18th Century Greek Painting*, në: *Allen Memorial Art Museum Bulletin* 29, 1 (1971), 11-59 dhe më gjerë mbi pikturën murale pasbizantine shkruan D. D. TRIANTAPHYLLOPULOS, *Die nachbyzantinische Wandmalerei auf Kerkyra und den anderen ionischen Inseln. Untersuchungen zur Konfrontation zwischen ostkirchlicher und abendländischer Kunst (15.-18. Jahrhundert)*, München 1985.

³ Si p.sh. G. C. TSIGARAS, *Piktorët Konstandin dhe Athanas nga Korça dhe veprat e tyre në Malin Athos*, në: *Aktet e Simpoziumit Ndërkombëtar „2000 vjet Art dhe Kulturë Kishtare në Shqipëri“*, Nëntor 16-18, 2000, Tiranë 2003, 277-290; K. KIRCHHAINER, *Das Ossuarium des Petrus- und Paulus-Klosters in Vithkuq (Südalbanien) und seine Freskendekoration (1750)*, në: *Makedonika* 34, 149-208; K. KIRCHHAINER, *Die Bildausstattungen der Kirchen von Voskopoje und ihre Stellung in der nachbyzantinischen Wandmalerei des 18. Jahrhunderts*, në: *Patrimoine des Balkans, Voskopoje sans frontières 2004*, Paris 2005, 53-73; K. KIRCHHAINER, *Die Malereien in den Gewölbezonen der Kuppelbasiliken von Voskopoje (Moschopolis)*, *Acta Studia Albanica* 1, 2007, 60-96; K. KIRCHHAINER, „Gepriesen seist Du, die höher ist als alle, erreichend den Thron Gottes“ – Überlegungen zu einem Koimesis-Zyklus in der Athanasioskirche in Voskopoje, në: *Makedonika* 37, 59-88; R. LOZANOVA, *Images of Slavic Saints in Moschopolis and Vithkuqi-Albania, Les Saints slaves dans l’histoire de l’église chrétienne; Annuaire de l’Université de Sofia „St. Kliment Ohridski“*, *Centre de recherches slavo-byzantines „Ivan Dujcev“*, t.92/11/2002, Sofia 2003, 177-

sore stilistikore të artit pasbizantin në zonën juglindore të vendit.

Lidhur me zhvillimin e pikturës murale pasbizantine në zonat e Epirit Verior dhe Thesalisë, duhet t'i kushtojmë vëmendje dy ndikimeve kryesore:

1. Ndikimit maqedonas, që e kishte gjenezën në Periudhën e Mesme Bizantine. Ky stil vazhdon të ruajë me besnikëri traditën e *Shkollës Maqedonase* dhe e pasuron më tej atë me realizëm dhe disa elementë të antikitetit⁴.

2. Dhe ndikimit të rëndësishëm Kreto-Venecian, apo të të ashtuquajturës "Shkolla e Kretës"⁵.

Kalimi nga shek. 15 në shek. 16 u shoqërua nga pikëpamja artistike nga një zbehje e traditës së *Shkollës Maqedonase*, drejt një arti me karakter më akademik, me një teknikë më të rafinuar dhe me ndikime perëndimore, tipare keto të *Shkollës së re të Kretës*⁶.

Kreta ishte një nga vendet më të rëndësishme të territorit ortodoks, si nga përmasa dhe potencia ekonomike, ashtu dhe nga aspekti artistik⁷. Megjithëse Kreta ishte nën sundimin venecian, ajo u kthye në një qendër të artit dhe kulturës greke, që gëzonte një situatë të favorshme në tregun evropian. Shumë artistë kretianë ishin "bilingual" në sensin, që ata mund të pikturonin në stilin italian, apo në stilin tradicional bizantin, sipas preferencave të porositësit⁸. Artistët kretiane mësuan teknikat e afreskave italiane si dhe mënyrën e tyre të paraqitjes duke rezultuar në një art ku gërshetohet perspektiva italiane me traditën bizantine⁹. Stili kretian dallon nga stili piktoresk paleolog. Figurat janë më grafike dhe fytyrat më të thata e më të ngrysurat. Piktura murale kretiane bazohet në paraqitje dramatike, të mbushura me figura ekspresive, me botë të theksuar emocionale, konture të sakta dhe plasticitet. Sipërfaqet janë të mbushura në prapaskenë me arkitekturë të pasur, ngjyra të gjalla dhe dashuri për detajet dekorative¹⁰. EkspONENTI më i rëndësishëm i *Shkollës së Kretës* është Theofanes Strelitzas, i njohur si Theofan Kretiani¹¹.

188; R. ROUSSEVA, Iconographic Characteristics of the Churches of Moschopolis and Vithkuqi (Albania), *Makedonika* 35, 2006, 163-179; R. ROUSSEVA, The legend of the last emperor and an unpublished eschatological scene from St. Nicholas church in Perhondi village (Albania, 14th century), në: *Niš & Byzantium VI*, Niš, Miša Rakocija, 2008, 231-243.

⁴ A. EFFENBERGER, N. ASUTAY-EFFENBERGER, *Byzanz Weltreich der Kunst*, München 2017, 326-327.

⁵ WEITZMANN 1987, 310.

⁶ TURNER 2003, 331.

⁷ EFFENBERGER, ASUTAY-EFFENBERGER 2017, 327.

⁸ I. P. CHOULIARÁS, The Depiction of Saint Constantine in Postbyzantine Monumental Art in Epirus and Macedonia. Iconographical Particularities, në: Miša Rakocija (ed.), *Niš and Byzantium*, Niš, 2014, 440.

⁹ M. CHATZIDAKIS, *From Byzanz to El Greco*, Museum für Byzantinische Kunst, Athene 1987, 43.

¹⁰ G. BLICKENDORF, „Maniera Greca“-Wahrnehmung und Verdrängung der Byzantinischen Kunst in der italienischen Kunstliteratur seit Vasari, në: *Sanat Tarihi Desterleri Nr. 6*, Özel Sayı. Okzident und Orient, Istanbul 2002, 113-125.

¹¹ Shumë dekore në Malin Athos mbajnë vulën e bashkëpunimit me artistë kretian, sidomos me Theofanes Strelitzas, i njohur si Theofan Kretiani (1500-1559), që shquhet si një nga përfaqësuesit më të njohur të *Shkollës së Kretës*. Ai u ftua me 1527 për të pikturuar kishën e manastirit Hagios Nikolaos Anapafsas në Meteora. Më pas, me 1535 ai u bë Kretiani i parë i ftuar për të pikturuar refektorin e Lavrës së Madhe në Malin Athos, së bashku me të bijtë Symeon dhe Niphon/Neophytos, ku ai zhvillon një stil të ri, në të cilin ndërthur pikturën ikonografike kretiane të shek. 16 me atë të asaj murale. TURNER 2003, 329.



Theofan Kretiani, Qarja e Krishtit, afresk, shek. XVI, Manastiri Stavronikës, Mali Athos.

Është e pamohueshme ngjashmeria stilistike e këtij artisti me Domenicos Theotokopoulos (El Greco-n) me prejardhje kretiane (1541-1614). Konturet e forta, ndërtimi piramidial i kompozimit, figurat e stërgjatura etj., janë disa nga tiparet e përbashkëta të piktorëve të kësaj periudhe me origjinë kretiane. Këto piktura dallojnë nga pasurimi i kompozimeve të tematikave fetare, nga ciklet e gjera ikonografike si dhe nga cilësia e jashtëzakonshme artistike¹².

Edhe mjeshtri ynë Onufri nga Neokastra (rreth 1500 – rreth 1578) gëzonte këto cilësi të larta artistike¹³. Ai duhej të kishte një formim të veçantë, siç dëshmon kaligrafia e mbishkrimeve të tij në punët e tij artistike¹⁴.



Onufri, Hyrja e Krishtit në Jeruzalem, afresk, mesi i shek. XVI, Kisha Shën Kollit, Shelcan, Elbasan.

¹² R. DHIMGJINI, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, Tiranë 2016, 91.

¹³ Punët e Onufrit janë ruajtur ende në kishën Evangjelistria dhe Shën Teodor në Kala të Beratit, Shën Nikolla në Shelcan dhe Shën Premte në Valsh, Shpat të Elbasanit (1554). Në kishën e Shpërfytyrimit dhe në atë të Shën Nikollas në Zercë, Prilep të Maqedonisë, në kishën e Anargjiteve Kosma e Damian dhe kishën e Apostujve në Kostur, Greqi si dhe në kishën e manastirit të Moldavicës (1537), Moldavi. Punët e tij shquhen për koloritin dhe forcë të veçantë artistike. K. KALLAMATA, *Ikona-Kuptimi dhe Simbolizmi*, Athinë1998, 28.

¹⁴ B. Öhrig, ed. *Ikonen aus Albanien: sakrale Kunst des 14. bis 19. Jahrhunderts. Katalog zu den Ikonen-Sälen der Ausstellung: Albanien- Reichtum und Vielfalt alter Kultur. August 2001 bis Januar 2002*, München 2001, 25.

Maniera e tij përmban elementë të artit paleolog, të *Shkollës Kretiane* si dhe të artit gotik¹⁵. Nga arti paleolog merr ai veshjet plot rrudha të figurave të tij, shkëmbinjtë në formë pyke, apo konstruksionet e ndërlikuara arkitekturore. Gjithashtu dhe kompozimet plot figura në skenat e tij biblike. Ndikimet e artit kretian ndiehen në pikturën e Onufrit në mënyrën e armatimit në figurat me veshje luftarake, në përcjelljen e muskulaturës në figurat e zhveshura biblike, në dekorimin e muraturave dhe relievve veneciane si dhe në plasticitetin e aureolave mbi shenjtoret. Por të dallueshme në stilin e tij janë dhe elementë arkitekturor gotik, si harku me majë apo dritarja rozete. Të gjithë këto ndikime arrin Onufri t' i asimilojë më së miri, duke i përcjellë vëzhguesit ikonografi brenda karakterit bizantin.

Edhe pasuesit e tij Nikolla dhe Onufër Qiprioti ishin pjesë e kësaj shkolle dhe shfaqin në veprat e tyre pikërisht këtë frymë artistike¹⁶.

Në shek. 16, në Malin Athos po rinovoheshin një numër i madh manastiresh, për pikturimin e të cilave u ftuan shumë artistë¹⁷, (ndërmjet të cilëve ishte dhe murgu kretian Theophanes Strelicas¹⁸). Murgjit e Malit Athos kërkonin të ruanin artin e manastireve të tyre në nivelin më të lartë të mundshëm dhe për këtë arsye ftonin shpesh piktorë të shquar kretiane¹⁹. Kështu emigrojnë në shek. 16 një numër i madh kretianësh drejt zonave ortodokse të pushtuara nga otomanet, ku zhvilluan një stil të veçantë kretian, që karakterizohej nga konture të mprehta, silueta të holla, draperi lineare dhe forma të përmbajtura²⁰.

Ky bashkëpunim ndërmjet artistëve kretianë me ato të Malit Athos çoi në zhvillimin e një stili bizantin të miksuar kreto-athonit²¹.

Por rritja gjithmonë e më e madhe e ndikimit artistik perëndimor, që vinte nëpërmjet kretianeve në Malin Athos, duhet të jetë pritur me ankth nga manastiret, sepse në këtë periudhë nis të shfaqet një numër në rritje, të manualeve të pikturës, të cilët theksojnë artin tradicional bizantin²².

Ky zhanër i pikturës pasbizantine kulmohet në shekullin e 18-të me hartimin e "Hermeneia-s"²³, së piktorit murg Dionisit nga Fourni-Agrafa (1670-1744), i njohur dhe si "Dorcaku i Pikturës" nga Mali Athos²⁴. Ky "udhëzues" i pikturës bizantine është më i

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Öhrig 2001, 26; V. PUZANOVA, Piktori i shquar shqiptar i shek. 16 Onufri nga Neokastra (Elbasani), *BUSHT* 3, 1953, 8; TH. POPA, Onufri-piktori i madh i shek. 16, *BUSHT* 1, 1962, 54.

¹⁷ GAUMA-PETERSON 1991, 156.

¹⁸ Atje pikturon ai më 1535 afreskat e manastirit të Stavronikas si dhe afreskat në Lavrën e Madhe.

¹⁹ TURNER 2003, 331.

²⁰ GAUMA-PETERSON 1991, 154.

²¹ TURNER 2003, 330.

²² Si shembulli i parë i këtyre manualeve njihet ai i peshkopit dhe piktorit serb, Nektarius nga Veles, më 1599. Një manual tjetër daton më 1674, i hartuar nga At Danilo, i cili punonte në manastirin serb të Chilandar-it në Malin Athos. Të dy manualët janë përshkruar të artit të pikturës bizantine. TURNER 2003, 331.

²³ Këto manuale të pikturimit njihen në territorin grek si „Hermeneia“ ndërsa në zonat sllave me emërtimin „Podlunniks“. *Malerhandbuch des Malermönchs Dionysios vom Berge Athos*, sipas përkthimit në gjermanisht nga Godehard Schäfer (Trier 1855), të ribotuar nga Slavisches Institut München, München 1983, f. 5.

²⁴ Ky është një nga dokumentët më të rëndësishëm, lidhur me pikturën murale të kishës ortodokse dhe skemës së programit ikonografik të përcaktuar në të. Murgu, piktori dhe shkruesi grek Dionisi nga Fourni jeton nga 1670-1744. Ai ishte i biri i një prifti në Fourni në rrethinat e Agrafës, në

njohuri ndër manualet e kësaj fushe dhe për shkak se ky shkrim përkthehet nga greqishtja që në vitin 1842 në gjuhen frënge dhe më 1855 në atë gjermane²⁵. Siç shprehet vetë murgu Dionis, përcjell ai nëpërmjet manualit mjeshtrinë dhe stilin e piktorit të mrekullueshëm bizantin Manuel Panselinos nga Thesaloniki²⁶. Hermeneia, manuali i pikturimit të Dionisit nga Fourn, përmban 456 kapituj dhe një trajtim të plotë të skenave të Testamentit të Vjetër, të cilat mungojnë në të gjithë librat e tjerë të kësaj natyre, që do thotë dhe që ky doracak ishte vepra më e plotë e këtij zhanri²⁷. E gjithë vepra e tij ndahet në tre pjesë: pjesa e parë përmban teknika të pikturimit, një pjesë e të cilave janë sot ende të pakuptueshme; pjesa e dytë prezanton skena ikonografike të Testamentit të Vjetër dhe pjesa e tretë dhe e fundit, ndodhitë nga Testamenti i Ri dhe paraqitjet e shenjtorëve²⁸. Manuali i pikturimit të Dionisit nga Fourn shërbente kështu si një udhëzues i artit të pikturës murale dhe ikonave bizantine, me synimin që arti i Manuel Panselinos të rivitalizohet dhe të inspironte zografët e tjerë postbizantin²⁹. Në shek. 16 bëhet i pashmangshëm ndikimi perëndimor për artin ortodoks nëpërmjet shpikjes dhe qarkullimit gravurës. Gravurat e drurit e sidomos ato të bakrit të gdhendësit Marcantonio Raimondi bënë të mundur përhapjen e tendencave artistike rilindase dhe manieriste tek artistët kretianë. Këto të fundit përcjellin elementë stilis-

Greqinë Qendrore. Dionisi shkoi në Kostantinopojë në moshën 12 vjeç, ndoshta për edukim të mëtejshëm. Katër vjet më vonë ai shpërngulet për në Malin Athos. Më 1721 pikturon Dionisi kapelën e Shën Demetrios në Vatopedi si dhe murin perëndimor të katolikonit të Docheiarion në Malin Athos. Në 1724-28 punon ai gjashtë ikona në kishën e Transfigurimit në Fourn, ndërsa pikturat e tij murale duhet të jenë shkatërruar më 1821. Ai u rikthye në Fourn më 1734 dhe në vitet 1740/41 funksionoi si kujdestar, patron i Patikanës së Kostantinopojës për konstruksionin e një shkollë në Agrapha. Letra që ai i shkruan patriarkut Neophytos më 1744 është shenja e fundit e jetës që ruhet prej tij.

Puna e tij e shkruar, që ka arritur të mbijetojë, përbëhet nga katër letra, 18 epigrame, dy punë liturgjike dhe më e shumta e versionit të „Doracakut të Pikturës së Malit Athos“ (Shën Petersburg, Saltykov-Shchedrin Pub. Lib., cod. gr. 708), për të cilën ai është dhe i njohur. Kjo vepër që njihet si „Manuali i Pikturës“ duhet të jetë shkruar ndërmjet viteve 1730-1734. TURNER 2003, 336.

²⁵SCHÄFER 1983, 6.
²⁶“... (unë, Dionisi) mora përsipër këtë talent të vogël që kam falë Zotit ta mësoj mirë, që do të thotë, që arti im pak i rëndësishëm, të cilin e kam mësuar që në rininë time duke u munduar zellshëm me shumë mund dhe kohë dhe që jam munduar aq sa kam mundur të kopjoj ikonat e shenjta dhe afresat e mrekullueshme të punuara në Malin Athos nga mjeshtri Manuel Panselinos nga Thesaloniki, punët e të cilit ndriçonin si hëna e artë me artin e tij të mrekullueshëm që tejkalonin dhe linin në hije punët e gjithë piktorëve më të hershëm e më të vonë...”, në: SCHÄFER 1983, 7.

²⁷Po aty, 6.

²⁸Në pikturat ikonografike është e detyrueshme ruajtja e një lloji tipi paraqitje, megjithatë variojnë ornamentet dhe veshjet, ngjyrat e përdorura aq shumë me njera-tjetren, sa mund të dallohen ngjashmeri vetëm ndërmjet pikturave të së njejtës „shkollë“ e ndonjëherë dhe vetëm në pikturat nga i njejtë atelier. Shpesh është menduar, që egzistonin tipe paraqitjesh të përcaktuara rreptë, që mund ta kenë zanafillën që në mijëvjeçarin e parë të artit bizantin, duke rritur rëndësinë e manualeve me shembuj dhe skica. Por në të vërtetë, rëndësia e këtyre doracakëve të pikturimit kishtar ka qendruar thjeshtë në përcimin e skemave bazë të paraqitjes, pa theksuar motive të veçanta e pa vendosur rregullore mbi linjat apo ngjyrat. Dhe këto doracakë mund të kenë patur për bazë në hartimin e tyre, manuskripte më të hershme, nga manastire dhe kisha të veçanta, të cilat sot janë ende të panjohura ose nuk janë përpiluar dhe studiuar shkencërisht. SCHÄFER 1983, 5.

²⁹Një vlerë të madhe kishte (dhe ka) ky manual i Dionisit nga Fourn jo vetëm për piktorët e artit bizantin por dhe për artistët e tjerë perëndimorë, të cilët donin të gjenin çelësin e pikturës bizantine. TURNER 2003, 331.

tikor perëndimorë dhe në piktorët e Athosit³⁰.

Përveç artit bizantin palaiolog dhe atij kretian me frymë perëndimore, shfaqen gjithashtu në shek. 16 në fshatrat rreth Kastorias disa atelierë në formën e punishteve familiare, të cilat organizoheshin në esnafe, me artizanë që lëviznin nëpër kishat që pikturoheshin në zonat e Epirit. Motivet që ata përdornin ishin shpesh të marra nga jeta e përditëshme, por nga ana tjetër ndieheshin në pikturat e tyre dhe tipare të pikturës italiane të shek. 14 dhe 15³¹.

Rënia ekonomike dhe pakësimi i sasisë së krishterëve në zonat e pushtuara nga Perandoria Osmane, çoi në fund të shek. 16 në përhapjen e një piktore disi fshatareske, që nuk e kishte më kualitetin e lartë krijues të Onufrit dhe rrethit të tij artistik³².

Atelieri më i njohur në këtë periudhë është ai i familjes piktore nga Linotopi pranë Kastorias (fshat vllëh në Greqinë Veriore), të cilët dekorojnë me punën e tyre në gjithë zonën e Epirit³³. Karakteristikat stilistike të artit të kësaj familjeje artistësh janë figurat e shëndosha e të ngjeshura, me qafë të shkurtër e trupa drejtkëndore dhe me shprehje të veçanta psikologjike nëpërmjet xhestikulimesh të forta. Mund të thuhet, se stili i piktorëve të Linotopit është i thjeshtë dhe disi primitiv, që korrespondon me prejardhjen e tyre fshatareske³⁴.

Piktura murale e fillimit të shek. 18, vjen pas një vakumi të ndieshëm të këtij arti fetar. Në shek. 17 vuan zhvillimi i artit kristian, ashtu si dhe politika dhe ekonomia e vendit, pasojat e sundimit osman³⁵. Ky ritëm i ngadaltë ndryshon falë politikave specifike ekonomike e fetare në zonën juglindore të Shqipërisë duke rezultuar në një shpërthim të ri kulturor në gjysmën e parë të shek. 18.

Kultura e regjioneve të Epirit (ku përfshihen Epiri Jugor, i cili i përket territorit grek dhe Epiri Verior i territorit shqiptar) u përcaktuan nga faktorë të përbashkët: si unifikimi në një gjuhë të përbashkët tregëtare, që ishte gjuha greke, kontakti ngushtë kulturor me qendrën në Malin Athos, si dhe nënshtrimi i mitropolive të tyre së njëjtës peshkopatë greko-ortodokse, që ishte ajo e Patrikanës së Ohrit.

Bibliografi

A. EFFENBERGER, N. ASUTAY-EFFENBERGER, *Byzanz Weltreich der Kunst*, München 2017.

B. ÖHRIG, ed. *Ikonen aus Albanien: sakrale Kunst des 14. bis 19. Jahrhunderts. Katalog zu den Ikonen-Sälen der Ausstellung: Albanien- Reichtum und Vielfalt alter Kultur. August 2001 bis Januar 2002, München 2001.*

³⁰ Punët e Marcantonio Raimondi-t (rreth 1475-1534) apo Giovanni Bellini-t (1430-1516) shërbenin si modele dhe për Theofan Strelicasin. GOUMA-PETERSON 1991, 156; D.PAPASTRATOS, *Greek Orthodox Religious Engravings, 1665-1889*, Athinë 1990, 23; M. CHATZIDAKIS, *Post-Byzantine Art 1430-1830*, në: M. Sakellariou, *Macedonia, 4000 Years of Greek History and Civilisation*, Athen 1993, 422-425.

³¹ Öhring 2001, 29.

³² Öhring 2001, 30.

³³ Mjeshtrat e Linotopit patën një aktivitet prej 86 vjetësh. Kjo dinasti përbëhet nga disa breza piktorësh që në vendin tonë kanë punuar në kishën e Shën Marisë në Dhiver të Delvinës (1604), kishën e Profet Ilias në Jorgucat të Gjirokastrës (1617), kishën e manastirit të Ungjillizmit në Vranishtë, kishën e Manastirit të Catistës (1626-27), kishën e Shën Nikollas në Saraqinisht (1630) dhe Manastirin e Profet Ilias në Stegopol (1653). KALLAMATA 1998, 29.

³⁴ Öhring 2001, 30.

³⁵ Po aty, 29.

- G. BLICKENDORF, „Maniera Greca“-Wahrnehmung und Verdrängung der Byzantinischen Kunst in der italienischen Kunstliteratur seit Vasari, në: *Sanat Tarihi Defterleri Nr. 6*, Özel Sayı. Okzident und Orient, Istanbul 2002.
- G. C. TSIGARAS, Piktorët Konstandin dhe Athanas nga Korça dhe veprat e tyre në Malin Athos, në: *Aktet e Simpoziumit Ndërkombëtar „2000 vjet Art dhe Kulturë Kishtare në Shqipëri“*, Nëntor 16-18, 2000, Tiranë 2003.
- I. P. CHOULIARÁS, The Depiction of Saint Constantine in Postbyzantine Monumental Art in Epirus and Macedonia. Iconographical Particularities, në: Miša Rakocija (ed.), *Niš and Byzantium*, Niš, 2014.
- K. KALLAMATA, *Ikona-Kuptimi dhe Simbolizmi*, Athinë1998.
- K. KIRCHHAINER, Die Malereien in den Gewölbezonen der Kuppelbasiliken von Voskopoje (Moschopolis), *Acta Studia Albanica 1*, 2007, 60-96.
- K. KIRCHHAINER, Das Ossuarium des Petrus- und Paulus-Klosters in Vithkuq (Südalbanië) und seine Freskendekoration (1750), në: *Makedonika 34*, 149-208.
- K. KIRCHHAINER, Die Bildausstattungen der Kirchen von Voskopoje und ihre Stellung in der nachbyzantinischen Wandmalerei des 18.Jahrhunderts, në: *Patrimoine des Balkans, Voskopoje sans frontières 2004*, Paris 2005, 53-73.
- M. CHATZIDAKIS, *From Byzanz to El Greco*, Museum für Byzantinische Kunst, Athene 1987.
- M. CHATZIDAKIS, Post-Byzantine Art 1430-1830, në: M. Sakellariou, *Macedonia, 4000 Years of Greek History and Civilisation*, Athen 1993.
- R. DHIMGJINI, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, Tiranë 2016.
- R. LOZANOVA, Images of Slavic Saints in Moschopolis and Vithkuqi-Albania, Les Saints slaves dans l'histoire de l'église chrétienne; *Annuaire de l'Université de Sofia „St. Kliment Ohridski“*, Centre de recherches slavo-byzantines „Ivan Dujcevo“, t.92/11/2002, Sofia 2003, 177-188 .
- R. ROUSSEVA, Iconographic Characteristics of the Churches of Moschopolis and Vithkuqi (Albania), *Makedonika 35*, 2006, 163-179.
- R. ROUSSEVA, The legend of the last emperor and an unpublished eschatological scene from St. Nicholas church in Perhondi village (Albania, 14th century), në: *Niš & Byzantium VI*, Niš, Miša Rakocija, 2008, 231-243.
- T. GOUMA PERTERSON, The Survival of Byzantinism in 18th Century Greek Painting, në: *Allen Memorial Art Museum Bulletin 29*, 1 (1971), 11-59.
- D. D. TRIANTAPHYLLOPULOS, *Die nachbyzantinische Wandmalerei auf Kerkyra und den anderen ionischen Inseln. Untersuchungen zur Konfrontation zwischen ostkirchlicher und abendländischer Kunst (15.-18. Jahrhundert)*, München 1985.
- TH. POPA, Onufri-piktor i madh i shek. 16, *BUSHT 1*, 1962.
- V. PUZANOVA, Piktori i shquar shqiptar i shek. 16 Onufri nga Neokastra (Elbasani), *BUSHT 3*, 1953.

Transferimi i Çmimit

Yildeze Sokoli

Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Financës;
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Abstrakt

Transferimi i çmimit është mekanizmi i çmimeve të një transaksioni që ndodh midis sipërmarrjeve të lidhura. Në realitet, ky koncept është më i rëndësishëm për organizatat të cilat janë të mëdha dhe që veprojnë me anë të njësisve të shumta. Duke qenë në përmasa të mëdha, vëllimi dhe operacione, menaxhimi i organizatës është gjithmonë i interesuar të dijë qendrat e kostos dhe qendrat e fitimit të organizatës për menaxhimin e tyre efektiv.

Nepermjet ketij punimi mund të themi se është një përpjekje e bërë në tregun shqiptar në një fushë ku mungojnë ose janë shumë të pakta të gjitha studimet e këtij lloji dhe me këto specifika. Punimi bëhet për të parë problematikat që biznesi ka hasur në transferimin e çmimeve në Shqipëri, mosmarrëveshjet eventuale të ndodhura midis tyre dhe administratës tatimore në lidhje me përcaktimin e çmimit të tregut ose asaj që njihet si ALP, Arms' Length Price.

The Buna River Velipoje Protected Landscape is a protected landscape area in North-western Albania, encompassing the estuary of Drin, the lagoon of Viluni, the river Buna and its estuary and the gulf of Drin that runs across Velipoja alongside the

Adriatic Sea. The area is categorized as protected landscape as category V and has further recognized as a wetland of international importance by designation under the Ramsar convention. Being part of European green belt too, the landscape is also important bird and plant area because it supports threatened and endemic species of birds and plants. Stretching between the Dinaric Alps, and the Mediterranean Sea the river of Buna is an outflow of the lake of Shkodra, the largest lake in Balkan peninsula, witch ultimately runs through the river until it drains into the Adriatic Sea. The landscape is an essential migration corridor at the season for hundreds of species between the Adriatic Sea and the inland. The region is explicitly marked by a relatively flat and shallow landscape supplied with alluvial forest, dry grasslands, marsh and shrublands, estuaries and freshwater wetlands and also beaches. The climate of the landscape is strongly under the influence of the Adriatic Sea and in the West and the Albanian Alps in North. Koeppen climate classification it experiences a Mediterranean climate characterized by warm to dry-hot summers and mild-wet to rainy winters. In the region live a variety of wildlife species. Golden jackal occurs in woodlands and marshes of the riverine floodplains. The coastline is dotted with sand dunes and offers great feeding opportunities for *bears*. In waters lives the *Common bottlenose dolphin* which prefers the coastal waters and river deltas. In the area leves also sea turtle and dalmatian pelican. The pelican use the salt pans around the region as feeding habitats during autumn. **Viluni lagoon** as all the Mediterranean lagoons ins one of the richest ecosystem in the area, with an exceptional value, but is also the most threatened. The lagoon supports high concentrations of birds, mammals, reptiles, amphibians, fish and invertebrate species that cannot be found anywhere else in the world. A lot of anthropogenic activities are causing problems for the wildlife and biodiversity in Viluni lagoon. The use of pesticides and other pollutants in the soil, in the water ecosystems are damaging the natural habitats of species. The decrease number of individuals of bird and fish populations, the decrease numbers of plants in forests of lagoons, Buna river and around the Shkodra Lake are indexes for a bad management of soil and poor practices for the protection of key species and key habitats. Forest vegetation once was much richer than today. One of the major degrading factors was the illegal cutting of trees to the limits of a complete deforestation. Forest vegetation is located in mountains administrative units, riverbanks in the Velipoja Reserve, Ada Island, villages of Reç, Sutjel, Shënkoll and Bahçallek. The vegetation of the lowland forest areas is mainly composed of several poplar species liard or aspen (*Populus* sp), spit (*Salix* sp), spruce (*Fraxinus* sp), oak (*Quercus* sp), acacia (*Robinia pseudoacacia*), cornel-bush (*Cornus mas*), hornbeam (*Carpinus bettulus*), marina (*Tamarix parviflora*), etc. There are over 50 species of fish in the Buna outskirts. Buna, along with the waters near it, represents one of the richest areas of poultry in the region. Buna river, Velipoja Reservoir, Domna's Cave, Viluni Lagoon, Shas Lake, Ulcinj Basin, Ulcinj's Lower Depersity Area are populated with poultry, especially in winter. Buna's waters and the associated wetland complex are an important station and one of Europe's migrating birds' routes to the Balkans. This is also the main reason for the richness of bird biodiversity, high dynamics and generating potential, with main indicators of mass migration and nesting Over 76% of the number of Buna bird species are migratory, while about 29% are nesters. In Buna there are counted about 50 species of waterfowl. The Buna Delta contains a diverse range of unique natural habitats that

are the habitat of twenty-four rare and endangered species and support for native and protected wildlife. Delta wetland carries more than 250 species of birds, some endangered. Delta also serves as the gateway to the region's 107 different fish species. Protected mammals in the area include large carnivores such as golden coyote and brown bear. The effective protection of plant and animal species in this region is an obligation under international agreements. A lot of awareness projects are implemented in Albania and especially in Shkodra urban ecosystem for the protection of the biodiversity and natural resources. Positive impacts for the biodiversity protection are starting from the good knowledge for the areas and their biodiversity and the strong link with the biodiversity conservation and awareness of people living in protected areas. The communities are more aware for the values of species, for the services that traditional and medical plants could give, for the good values of flora and fauna living in the forest of Shkodra urban ecosystem. The most important initiative was the involvement of the business in good practices for the management of the biodiversity with environmentally friendly investments. The use of natural resources and biodiversity for economic development is not sustainable and a lot of areas are not well developed although they have big potential for ecotourism or sustainable agriculture. The real situation of flora and fauna and the status of species are important for assessing the value of ecosystem in economical perspective. These species and other natural resources should be considered as an asset for the economic value of ecosystem and as a service for the community living in natural areas. The natural ecosystems should be restored in a biological harmony and the economical use of them should be sustainable.

The plan for the biodiversity protection for the years 2017-2022 has the vision "The protection of the biodiversity in its complexity and the compilation of an action plan for its sustainable use with the goal to protect the environment" and its strategic priorities are linked with the use and the protection of the biodiversity.

- Assessment of ecological situation in Shkodra Region
- Identification of problems and factors that are threatening our natural habitats and their biodiversity.
- Creation of new strategies and action plans for key habitats and key species.
- Increase the awareness of the community and stimulate eco friendly investments in natural areas.
- Integrate the management of the biodiversity with plans and development strategies in the territory.
- Promote the investments in eco and agrotourism.

All these priorities are considered important for the sustainable use of natural resources and the sustainable use of land and biodiversity. All these priorities bring to the protection of the biodiversity in an integrated way and the sustainable use of the biodiversity. We considered that are necessary also the development of a legal and institutional framework with the standards of EU and their effective implementation and the use of the practices that stimulate the sustainable development and ecotourism and the best management practices for the biodiversity as a mechanism for the protection. Actors should integrate the politics for biodiversity protection in all relevant sectors with the economic development in order that the national strategy for the biodiversity protection is taken into consideration during the decision-making

process. An important step is the involvement of private sector in biodiversity protection and protection of natural resources. Encourage the sustainable land use, the sustainable use of genetic resources for food and in agriculture. Encourage the system of certification of forest in order to have the sustainable use of forest. Sustainable use of wetlands with good practices and development of management plans for protected areas is considered important for economical profit and the sustainable development in the Region. Ecotourism is considered a good industry that is contributing to the economic development of the ecosystem. Shkodra ecosystem is having big potential for ecotourism. The community should consider natural resources and biodiversity as an asset for ecotourism development but should search for more investments in transport and infrastructure, eco-hotels and accommodation's structure.

Recommendations and action for ecosystem approach

- Assessment of ecological situation in Shkodra Region is important to have an clear overview of the real situation of natural resources.
- Identification of problems and risks that are threatening our natural habitats and their biodiversity is important to evaluate the use of land, forests and biodiversity resources.
- Creation of new strategies and action plans for key habitats and key species should be part of projects and priority for the investments in order to protect the biodiversity in the Region of Shkodra.
- The local authorities and the civic sector should work hardly to increase the awareness of the community and stimulate eco friendly investments in the Region.
- Integrate the management of the biodiversity with plans and development strategies in the territory for the sustainable development in our Region.
- Priority activities should be:
 - Improvement of the quality of environment and natural habitats.
 - Decrease of the eutrofication process in water ecosystems.
 - Reforestation of several surfaces in north forest.
- Promote the alternative sources of energy and smart technology in the investment in order to protect the environment and biodiversity.

Recommendations and conclusions

Flora and fauna are threatened due to misuse, over-utilization and poor management of these resources of great economic, environmental, and social value. Mostly these problems have arisen in recent decades and are primarily related to the environmental education of the population and demographic movements of the population in areas of natural value.

On the territory of the Wetland Complex of Buna River and Viluni Lagoon has favorable conditions for people's housing due to climate, soft soil, fresh-water natural resources. Territories with natural values in general as well as those with high biodiversity values in particular have been seen not only as auxiliary, but as inseparable from the development of many local economies. Many of the biodiversity values are utilized directly. One of the developed economic sectors has been fishing. The local

population of areas around Lake and Buna river engages in fishing for family consumption but also for trade, but this engagement is lower in Viluni lagoon. The zoos, around the lake, provide the best opportunity for carving a carp as a very important commercial type. Another economic benefit from exploitation of biodiversity is the use of forests, but also the floor of the medicinal herbs or even the tanning plants. The forests of the area are used for heating materials but also as building material. The wetland vegetation has been used for artisanal production, e.x. production of xunth baskets or willow birch. Today there is no data that can still be used for this purpose. There is not much data on business activities of gathering or processing of medicinal and ethereal plants. Often areas of natural value also have the value of the indirect services that they provide for the communities living in them: e.g., wetland areas serve as preventative of flooding, flooding in marshy areas is a regular occurrence in the season, wetland vegetation is the initial water retention filter.

Because the core of biodiversity consists of species, habitats and ecosystems, their protection must begin with the management of critically threatened species and habitats such are: *Acipenser sturio*, *Lynx Lynx*, *Taxis baccata*) etc, or even habitats at risk of irreversible extinction like Franc Joseph's island. Their conservation and management would result in local and national economic and educational benefits for the areas around the Lake and Buna River and all of the water basin. Flood protection becomes a priority since the economic and social weight of this phenomenon exceeds the magnitude of isolated events, making it imperative for intervention with regional-scale development projects.

In this priority action area, all public and private actors find a co-operation challenge and the need to step up interventions as soon as possible at the level of EU technologies and the best organizations that use developed countries today.

In the territory of the Dajc municipal unit, as well as in other areas of natural value in recent years, there have been rapid socio-economic developments that have caused the decline of the population in rural areas, the increase of the average age of the population, changes in the population, the way of land use and other natural resources. Traditional agriculture has been replaced more by tourism and services received from natural areas.

This is why sustainable development in these areas is recommended through the creation of ecosystem services, bringing to the attention of the community the development of socio-economic activities such as agro-tourism and eco-tourism.

References

- Dibra A. and Mazreku. V. (2021) How to prevent climate changes impact in some lagoons in Albanian Adriatic area.
- Mazreku. V. and Dibra A. (2021) Evidence from small scale energy poverty interventions in Vlora municipality with impact on climate change
- Mullaj et al. (2017). Një vështrim përmbledhës mbi praktikat e blerta dhe pyllëzimin në Shqipëri.
- Rakaj. M. (2009) Biodiversiteti.
- UNDP, Third National Communication to the United Nations Framework Convention on Climate Change | UNDP in Albania, 2016
- Bouzarovski, S.; Thomson, H. Transforming Energy Poverty Policies in the European Union:

- Second Annual Report of the European Union Energy Poverty Observatory; EU Energy Poverty Observatory: Manchester, UK, 2019.
- Bouzarovski, S.; Tirado-Herrero, S. The energy divide: Integrating energy transitions, regional inequalities and poverty trends in the European Union. *Eur. Urban. Reg. Stud.* 2015, 24, 69–86. [CrossRef] [PubMed]
- Gouveia, J.P.; Seixas, J.; Long, G. Mining households' energy data to disclose fuel poverty: Lessons for Southern Europe. *J. Clean. Prod.* 2018, 178, 534–550. [CrossRef]
- Milieukontakt Albania, Vlora pilot site assessment report in Albanian (with an executive summary in English). Available online: [D1.1-Vlora-Albania-Pilot-site-2.pdf](#) (empowermed.eu).
- Lluc Canals Casals; Jordi Pascual Data recording, collection framework and analysis framework. Available online: [Data-recording-collection-framework-and-analysis-framework.pdf](#) (empowermed.eu)
- Eurostat. Electricity Prices for Household Consumers–Bi Annual Data (from 2007 Onwards). Available online: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=nrg_pc_204 (accessed on 13 August 2021).
- (GIZ 2021) Flood risk management Plan Shkoder area (GIZ 2021).
- (REC, 2028) Vlersësimi i gjendjes së mjedisit detar në Shqipëri (REC, 2028).
- (UNDP, report 2018) Voluntary national review on SDG (UNDP, report 2018).
- (UNDP, Study Report 2020) Local vulnerability and capacity assessment in Albania (UNDP, Study Report 2020).
- UNDP/INSTAT Sustainable development goals UNDP/INSTAT Albania.

Arrestimi në flagrancë i kryer nga policia gjyqësore dhe citizen's arrest

Olgert Rumnici

Prokuror, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë

Abstrakt

Në këtë punim do të trajtojmë veprimin procedural të arrestimit në flagrancë, si një ndër masat, e quajtura para-siguruese, që kufizojnë të drejtën e lirisë fizike të individit. Kjo e fundit është një e drejtë që është parashikuar në KEDNJ, gjithashtu, është adoptuar edhe nga Kushtetuta e Shqipërisë, por paralelisht me karakterin e rëndësishëm të saj, është njohur dhe fakti se kjo e drejtë nuk është absolute dhe në kushte të caktuara, të parashikuara me ligj, mund të kufizohet. Pikërisht, kushtet e kryerjes së këtij veprimi procedural, veçanërisht detyrat e policisë gjyqësore dhe të organeve proceduese do të jenë objekt i këtij punimi. Një pjesë e rëndësishme e këtij punimi do të jetë edhe trajtimi i konceptit të arrestimit të kryer nga qytetarët, i njohur në doktrinën dhe praktikën e juaj si *'citizen's arrest'*, për të parë nëse ky mund të ketë ndonjë përjashtim nga arrestimi 'klasik' i kryer nga policia. Kjo temë merr shkas nga praktika hetimore dhe gjyqësore e organeve proceduese në interpretimin dhe zbatimin e këtij veprimi procedural, dhe përpqet të ofrojë disa standarde për kuptimin dhe vlerësimin e drejtë të tij.

Fjale Kyçe: Arrestimi në flagrancë, policia gjyqësore, citizen's arrest.

1. Kuptimi i të drejtës për liri dhe siguri. Standardet e KEDNJ-së dhe Kushtetutës së Shqipërisë për kufizimin e saj

E drejta për liri dhe siguri përbën një nga të drejtat dhe liritë themelore të të drejtave të Njeriut. Megjithatë, duhet theksuar që kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të kufizohet në rastet e përcaktuara nga ligji.

E Drejta për liri dhe siguri është e sanksionuar në nenin 5 të KEDNJ-së, ku përcaktohet se:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale.

Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

(...)

c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

(...)

Sa më sipër, KEDNJ-ja, ka sanksionuar se e drejta për të mos u privuar nga liria është e drejtë themelore e njeriut, por jo absolute. Në dispozitën e sipërcituar, janë sanksionuar rastet se kur kjo e drejtë mund të kufizohet, ku një ndër rastet kur e drejta e lirisë mund të kufizohet është rasti, kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj.

Në vështrim të dispozitës së sipërcituar, GJEDNj-ja, në jurisprudencën e saj ka argumentuar se një person mund të ndalohet në vështrim të nenit 5 § 1 c), vetëm në kuadër të një procedure penale, me qëllimin për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur dyshohet se ka kryer një veprë penale (GJEDNj, Ječius k. Lituanië, § 50; Schëabe e M.G. k. Gjermanisë, § 72). Ekzistenca e "arsyeve të besueshme për të dyshuar" se është kryer një veprë penale presupozon atë të fakteve ose informatave të mjaftueshme për ta bindur një vëzhgues objektiv që individit në fjalë mund ta ketë kryer veprën penale (GJEDNj, Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit, § 88; Erdagöz k. Turqisë, § 51; Fox, Campbell e Hartley k. Mbretërisë së Bashkuar § 32).

Përveç sa më sipër, GJEDNj-ja, ka analizuar në jurisprudencën e saj, atë që konsiderohet "heqje/kufizim lirie". Kështu, Gjykata ka argumentuar se neni 5 i Konventës ka parasysh lirinë fizike të personit. Kjo dispozitë ka si qëllim të sigurojë që askush të mos zhvishet prej saj në mënyrë arbitrare. Ai nuk ka të bëjë me kufizime të thjeshta ndaj lirisë së qarkullimit, të cilat përcaktohen nga një dispozitë më vete, konkretisht neni 2 i Protokollit nr. 4 (GJEDNj, Creangă k. Rumanisë [DhM]*, § 92; Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulëta, § 58).

Dallimi ndërmjet kufizimeve ndaj lirisë për të qarkulluar, që janë aq të rënda sa për të përbërë një heqje lirie në kuptimin e nenit 5 § 1, dhe atyre që nuk mbeten veçse kufizime të thjeshta ndaj lirisë për të qarkulluar e që i përkasin vetëm nenit 2 të Protokollit nr. 4, është një dallim shkalle ose shpeshhtësie, por jo natyre ose thelbi (GJEDNj Guzzardi k. Italisë, § 93; Rantsev k. Qipros dhe Rusisë, § 314; Stanev k. Bullgarisë [DhM], § 115). Heqja e lirisë nuk kufizohet vetëm tek situata klasike e ndalimit pas një arrestimi ose dënimi. Ka edhe shumë trajta të tjera (GJEDNj Guzzardi k. Italisë, § 95).

Për të përcaktuar nëse një individ i është "hequr liria" në kuptimin e nenit 5, duhet nisur nga situata konkrete dhe të mbahen parasysh një tërësi kriteresh si lloji, kohëzgjatja, pasojat dhe mënyrat e zbatimit të masës së marrë në shqyrtim (GJEDNj, Guzzardi k. Italisë, § 92; Medvedyev me të tjerë k. Francës [DhM], § 73; Creangă k. Rumanisë [DhM], § 91). Detyrimi për të mbajtur parasysh "llojin" dhe "mënyrat e zbatimit" të masës në fjalë i jep mundësi Gjykatës që t'u kushtojë vëmendje kontekstit dhe rrethanave specifike të kufizimeve ndaj lirisë që i largohen asaj situatë tipike që është burgosja. Në fakt, konteksti në të cilin përfshihet masa përbën një faktor të rëndësishëm sepse është e zakonshme që, në shoqëritë moderne, të ndodhin situata në të cilat publikut mund t'i kërkohet të durojë disa kufizime ndaj lirisë së qarkullimit ose ndaj lirisë së personave në interesin e së mirës së përbashkët (GJEDNj Nada k. Zvicrës [DhM], § 226; Austin me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], § 59). Nocioni i heqjes së lirisë në kuptimin e nenit 5 § 1 përmban njëherazi një aspekt objektiv, konkretisht mbylljen e një personi brenda njëfarë hapësire të kufizuar për një periudhë kohore të konsiderueshme, dhe një aspekt subjektiv, domethënë që ky i fundit nuk ka dhënë në mënyrë të vlefshme pëlqim për mbylljen e tij (GJEDNj Storck k. Gjermanisë, § 74; Stanev k. Bullgarisë [DhM], § 117).

Sa më sipër, vetëm kufizimi i lëvizjes për një kohë të caktuar, nuk përbën automatikisht heqje lirie. Për të qenë përpara heqjes së lirisë, kërkohet të analizohen elementët e anës objektive, kohëzgjatja, pasojat etj..., pasi mund të ndodhë që të gjendemi përpara kufizimeve të thjeshta të lirisë për të lëvizur dhe nuk përbëjnë heqje lirie në vetvete. Kështu liria e lëvizjes është e përcaktuar në Nenin 2 të Protokollit 4 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ku parashikohet se edhe kjo e drejtë nuk është absolute, por mund të kufizohet në përputhje me ligjin, dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike,

për të ruajtur rendin publik, për të parandaluar kryerjen e një krimi, për mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Në të njëjtën linjë, si KEDNj-ja, edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka përcaktuar si një nga të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për të qenë i lirë. Ashtu si KEDNj-ja, edhe sipas Kushtetutës, kjo nuk është një e drejtë absolute dhe kufizohet në rastet e përcaktuara. Konkretisht Neni 27 i Kushtetutës parashikon se:

"1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

(...)

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka theksuar se: *"Lejimi i këtij kufizimi tenton të balancojë nevojën për të vepruar kundër veprave penale ndaj pretendimeve të lirisë personale që çdo individ normalisht ka, dhe që duhet të garantohet nëpërmjet procedurave ligjore"* (Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 02.04.2012).

2. Natyra juridike e arrestimit në flagrancë

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, është një nga ligjet kryesore në Republikën e Shqipërisë, që përcakton procedurën, kohën dhe subjektet që kanë të drejtë të kufizojnë lirinë e personit sipas pikës c) të paragrafit 1) të nenit 27 të Kushtetutës.

Një nga rastet e ligjshme kur mund të hiqet apo kufizohet liria e një personi, është kur kapet në kushtet e flagrancës. Konkretisht ky rast është parashikuar nga neni 251 i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë dispozitë parashikohet si më poshtë:

"1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.

2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një veprë penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet.

3. Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2.

4. Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep një kopje të tij".

Ndërsa në nenin 252 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi ka parashikuar nocionin e flagrancës, duke përcaktuar se *"Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi viktimë ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale".*

Arrestimi në flagrancë, po ashtu si ndalimi, që ka kushte të tjera, por me efekt të njëjtë si arrestimi, duket si masë sigurimi, sepse në të vërtetë, nëpërmjet këtij veprimi

realizohet kapja e të dyshuarit dhe izolimi i tij (Islami, H dhe të tjerë, 2007). Megjithatë, ai nuk është masë sigurimi, por veprim procedural që diktohet nga rrethanat konkrete të flagrancës. Arrestimi në flagrancë është veprim që kryhet me iniciativë të policisë gjyqësore, i autorizuar nga ligji procedural penal dhe i kontrolluar nga prokurori. Rrethanat e flagrancës dhe të ikjes e bëjnë të pamundur zbatimin e rregullave të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit nga gjykata, prandaj ligji ka lejuar kryerjen e këtyre veprimeve procedurale nga policia gjyqësore. Pasi vleftësohen nga gjyqtari në seancë gjyqësore, mbi kërkesën e prokurorit, ndaj të arrestuarit apo të ndaluarit caktohet masa e sigurimit (Islami, H dhe të tjerë, 2007).

Edhe pse konsistojnë në kufizim apo heqje të lirisë vetjake, siç janë edhe masat e sigurimit personal, sepse disponohen nga policia gjyqësore dhe prokurori që nuk janë autoritete gjyqësore, si dhe sepse vendosen përpara vlerësimit të gjykatës, "arresti në flagrancë" dhe "ndalimi" formohen si *masa para-sigurimi* mëvetësisht të disiplinuar dhe nuk përfshihen në masat e sigurimit personal të disponueshme nga gjykata me kërkesën e prokurorit (Lara, Dh., 2010).

Arrestimi dhe ndalimi, njëlloj si masat e sigurimit personal, kanë qëllimin të privojnë nga liria autorin e dyshuar për një vepër penale të caktuar, të parashikuar nga ligji me kriterin e taksativitetit. Megjithatë, ato janë përkufizuar si masa shtrënguese parasiguruese kryesisht për dy arsye: sepse kanë *natyrë instrumentale* dhe *paraprake* në krahasim me rregullimin e parashikuar nga masat e sigurimit; sepse *bazohen në parakushte autonome*, në krahasim me ato të parashikuara për masat e sigurimit personal (Laronga, A., 2008).

KPrP ka pranuar parimin e përgjithshëm sipas të cilit "vetëm gjyqtari ka kompetencën të aplikojë një masë sigurimi që kufizon lirinë personale, masë që ka efekte të vazhdueshme në kohë, edhe pse masa të tilla kanë një kohëzgjatje maksimale të caktuar". Konform kësaj qasjeje, arrestimi në flagrancë dhe ndalimi kualifikohen për shkak të karakterit të tyre, si masa të përkohshme, të zbatueshme në situata urgjence kur nuk mund të aktivizohet efektivisht procedimi për masë sigurimi. Ato, siç dihet, janë të lidhura me pushtetin e policisë gjyqësore për të marrë në raste të jashtëzakonshme domosdoshmërie dhe urgjence, të treguar nga ligji në mënyrë taksative, masa të përkohshme kufizuese ndaj lirisë së individit, pa rënë ndesh me nevojën për një garanci nga autoriteti gjyqësor. Gjykata investohet për të verifikuar brenda afateve shumë të shkurtër kohorë, ligjshmërinë e kufizimit të lirisë personale. Për këtë arsye, masat e arrestimit dhe të ndalimit, edhe pse konvalidohen nga gjyqtari, nuk përbëjnë titull përfundimtar për ndalimin dhe efektet e tyre janë të destinuara të shuhen nëse brenda afateve të përcaktuara nga ligji nuk ndiqen nga aplikimi i masave të sigurimit. Miratimi i masave *para - siguruese* është i kushtëzuar nga parametra normativë të ndryshëm nga ato që kërkohen për aplikimin e masave të sigurimit personal. Për disiplinën e arrestit është e huaj çdo vlerësim bazuar në nevojat e sigurimit. Nevojat e sigurimit duhet të vlerësohen në një moment të mëvonshëm, në momentin kur prokurori bën kërkesën për caktimin e masës së sigurimit dhe në momentin kur gjyqtari miraton kërkesën e prokurorit për caktimin e masës shtrënguese duke zëvendësuar në këtë mënyrë masat *para - siguruese* të kryera nga policia gjyqësore (Laronga, A., 2008).

3. Kushtet e arrestimit dhe kuptimi i flagrancës

Në kushtet e përgjithshme që ekzistojnë për marrjen e masave të sigurimit, një ndër

to, është dhe *standardi i dyshimit të arsyeshëm, i bazuar në prova*, megjithatë në Kod nuk parashikohet se ky standard është i aplikueshëm për arrestimin në flagrancë si një masë para-siguruese. Në arrestimin në flagrancë një detyrë e rëndësishme i ngarkohet policisë gjyqësore. Policia gjyqësore, duke qenë se është organi kompetent sipas ligjit procedural penal, për të kryer këtë veprim procedural, ka detyrimin për të përligjur në procesverbalin që mbahet për këtë qëllim, shkakun e arrestimit në flagrancë dhe të dhënat konkrete që tregojnë për ekzistencën e gjendjes së flagrancës. Në rastin e arrestimit në flagrancë Kodi nuk kërkon kriterin e *dyshimit të arsyeshëm*, sepse flagranca është një gjendje fakti. Kur personi kapet në njërin nga rastet e flagrancës së kryerjes së veprës penale, autorësia e krimit rezulton nga një situatë konkrete fakti, ndaj nuk ka kuptim të vendoset kriteri i dyshimit, qoftë edhe në kufijtë e arsyes. Megjithatë, në nenin 256 të Kodit parashikohet se kur prokurori merr në pyetje të arrestuarin apo të ndaluarin, ai i njofton faktin për të cilin procedohet dhe *arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij* dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe *burimet*. Kjo do të thotë se gjendja e flagrancës duhet të provohet dhe ky detyrim i takon prokurorit.

Kushtet që sherbejnë si bazë për ta arrestuar në flagrancë një person që ka kryer një vepër penale, nuk duhet të jenë supozime, por të krijuara mbi bazën e fakteve konkrete, të cilat për shkak të kohës së shkurtër midis momentit të ndodhjes së veprës dhe marrjes së vendimit për të ndaluar personin¹, nuk mund të verifikohen dhe saktësohen në atë shkallë që është e nevojshme për të vendosur marrjen e një mase më të qëndrueshme ndaj tij, siç mund të jetë një masë sigurimi. Faktet mbi bazën e të cilave mund të krijohen dyshimet se një person ka kryer një vepër penale, ndaj të cilit organeve kompetente u lind e drejta të zbatojnë masën e arrestimit në flagrancë, mund të jenë të ndryshme, por ato gjithmonë duhet t'i referohen veprës penale që është kryer dhe të hedhin dritë për lidhjet që ekzistojnë midis kësaj vepre dhe një personi të caktuar si autor i saj (Spiro, S., 1983).

Arrestimi në flagrancë është një veprim procedural që kryhet mbi një bazë reale, mbi një të dhënë konkrete e jo të supozuar dhe as të marrë me mend. Në qoftë se kjo bazë reale, këto të dhëna konkrete mungojnë, është e qartë se zbatimi i këtij veprimi procedural është i pabazuar. Shkalla e bazueshmërisë për zbatimin e arrestimit në flagrancë ndaj një personi që dyshohet se ka kryer vepër penale në kushtet *kur është kapur në kryerje e sipër, gjatë ose menjëherë pas kryerjes së saj, apo kur është kapur me sende e prova materiale*, do të varej nga rrethanat e veçanta të çdo rasti konkret, të cilat sigurisht duhet të provohen. Provueshmëria e gjendjes së flagrancës vlerësohet si nga organet që kryejnë arrestimin në flagrancë, ashtu edhe nga prokurori kur kontrollon ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e tij (Baboçi, S., 1979).

Në rastin e flagrancës ligjvënësi ka normuar një ndarje apo një shkallëzim në dy situata. Kështu, pjesa e parë e dispozitës që normon *"kapja në kryerje e sipër të veprës penale ose ndjekja e menjëhershme pas kryerjes së saj nga policia, i dëmtuari apo për persona të tjerë"*, formon për të kapurin një gjendje flagrance. Ndërsa, pjesa e dytë *"kapja me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale"*, formon një gjendje gati-flagrance. Situata e parë është flagrante, sepse raporti kohor ndërmjet faktit dhe njohjes është i njëkohshëm apo i menjëhershëm dhe njohja e ekzistencës së veprës dhe e autorit vjen e perceptohet drejtpërdrejtë nga shqisat ndjesore tek oficeri, agjenti i policisë gjyqësore ose tek i dëmtuari apo personi tjetër, pa nevojën e ndonjë prove që jep

¹ Në Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale shqiptare (1979), me ndalim ligjvënësi kishte parasysh rastet e flagrancës që njohim sot në Kodin aktual.

njohje. Pra, nëse ekziston njëkohshmëria e njohjes dhe perceptimi i drejtëpërdrejtë, kapja aty për aty apo nëpërmjet ndjekjes së menjëhershme, është element fakti i cili krijon besueshmërinë e tyre. Prandaj, është e nevojshme që ndjekja duhet të jetë një veprimtari kronologjikisht menjëherë pas kryerjes së veprës penale, e pandërprerë dhe në vazhdim, veti këto që krijojnë besueshmërinë. Ndërsa, situata e dytë është gati-flagrante sepse raporti kohor ndërmjet faktit dhe njohjes është më i largët dhe i distancuar dhe bindja formohet nga njohja që jep dukja e kapjes në befasi me sendet, provat materiale, pra jo e drejtëpërdrejtë (Lara, Dh., 2010).

Në rastin kur personi i dyshuar është arrestuar sipas dy rasteve të para të flagrancës, pra kur është kapur në kryerje e sipër të veprës penale apo kur menjëherë pas kryerjes së saj ndiqet nga policia gjyqësore, i dëmtuari ose nga persona të tjerë, është e kuptueshme se për sa i përket problemit se ai është autor i veprës penale, nuk ka asnjë dyshim. Në rastin e parë, autori i veprës penale është parë dhe është kapur në vendin e kryerjes së veprës. Edhe në rastin e dytë, përsëri është fjala për vepra të dukshme dhe autori është parë, por nuk është kapur, prandaj ndiqet (Islami, H dhe të tjerë, 2007). Për sa i përket rastit të tretë të gjendjes së flagrancës, në këtë rast sendet dhe provat materiale janë ato që determinojnë në kryerjen e arrestimit në flagrancë. Gjurmat e veprës penale, thika, arma, gjaku, sendet e vjedhurar etj., janë prova materiale që krijojnë kurdoherë dyshime të bazuara se personi të i cili këto u gjetën, mund të jetë autori i veprës penale (Baboçi, S., 1979). Arrestimi në flagrancë i personit me sende dhe prova materiale përbën një fakt, i cili tregon lidhjen që ekziston midis një personi dhe një veprë penale të ndodhur, lidhje që tregon se ky person është autor i mundshëm i kësaj veprë, por që ende nuk është verifikuar plotësisht një gjë e tillë. Për të arritur në një përfundim të tillë, në këto raste është e nevojshme që të kryhen veprime hetimore, rezultatet e të cilave plotësojnë me prova të plota tablonë e qënies së një personi autor i një veprë penale (Spiro, S., 1983).

Natyrisht, edhe pse gjendja e flagrancës është një situatë fakti që perceptohet *ictu oculi*, vetëkuptohet se nuk mund të pretendohet që në një fazë të tillë, të ketë të dhëna të tilla që të argumentojnë në mënyrë të plotë ekzistencën e veprës penale, fajësinë e personit autor të kësaj veprë si dhe të rrethanave të tjera, sqarimi i të cilave ka rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Argumentimi në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme i këtyre aspekteve është detyrë e hetimit, dhe në këtë vështrim, as që duhet kërkuar prania si tërësi e tyre në momentin e arrestimit (Mosko, T., dhe Kolaneci, F., 1980).

4. Detyrat e policisë gjyqësore dhe organeve proceduese në vlerësimin e arrestimit

Në momentin e kryerjes së arrestimit në flagrancë, policia gjyqësore e dokumenton këtë veprim procedural në procesverbalin e arrestimit në flagrancë, në të cilin tregon me saktësi vendin, ditën dhe orën e arrestimit, gjeneralitetet e personit të arrestuar, veprën që ka ndodhur dhe të dhënat që e vërtetojnë atë. Pavarësisht se në situatën e flagrancës kemi të bëjmë më një perceptim të drejtëpërdrejtë të faktit, që krijon bindje te policia gjyqësore, standardi minimal i *mjaftueshëm* që legjitimon arrestimin në flagrancë është dyshimi i arsyeshëm. Policia gjyqësore në situatën e flagrancës duhet të vlerësojë së pari, *nëse fakti përbën apo jo veprë penale*. Vetëm pas përcaktimit pozitiv, asaj i nevojitet që të bëjë *një vlerësim të përafërt të cilësimit ligjor të saj*, vlerësim i cili lehtëson dhe sqaron nëse konkurrojnë kushtet e përcaktuara në nenin 251/1 të KPrP (Lara, Dh., 2010). Megjithatë, në perceptimin e drejtëpërdrejtë të flagrancës, policia gjyqësore mund të gabojë si në lidhje me perceptimin e rrethanave, ashtu

edhe për cilësimin juridik të faktit që percepton. Ekzistenca e gjendjes së flagrancës e prezumon standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova (Lara, Dh., 2010). Një konkluzion i tillë vjen në përputhje me standardin që kërkon neni 5/1/c i KEDNJ-së dhe neni 27/2/c i Kushtetutës sonë për arrestimin. Praktika e GJEDNJ e trajtuar më sipër është e konsoliduar në këtë drejtim duke afirmuar se masat që kufizojnë lirinë e individit, duhet të bazohen në dyshimin e arsyeshëm (GJEDNJ, *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 29 Nëntor 1988; GJEDNJ, *Murray dhe kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 Tetor 1994). Prandaj, doktrina jonë ka mbajtur qëndrimin se policia gjyqësore kur kryen një arrestim në flagrancë duhet të mbajë parasysh *kriteret e përgjithshme* për caktimin e masave të sigurimit, ku përfshihet dhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm (Islami, H dhe të tjerë, 2007). Gjithsesi, duhet të kuptohet se vërtetimi i gjendjes së flagrancës e nënkupton përmbushjen e kriterit të dyshimit të arsyeshëm. Për më tepër, duket se edhe gjykatat në praktikën e tyre të vleftësimit të arrestit në flagrancë i kushtojnë vëmendje faktit të konstatimit të gjendjes së flagrancës. Kjo përforcohet edhe nga kodi ynë, i cili mjaftohet vetëm me vërtetimin e gjendjes së flagrancës. Sapo vërtetohet gjendja e flagrancës, për prokurorin dhe gjykatën konsiderohet se arrestimi është i ligjshëm. Për këtë qëllim në vijim po studiojmë disa vendimeve gjyqësore.

Gjykata në seancën e vleftësimit të arrestit në flagrancë mjaftohet me vlerësimin e kushteve që parashikohen në KPrP, në lidhje me ekzistencën e gjendjes së flagrancës(n. 252) dhe llojin i veprës penale(n. 251). Masa e arrestimit në flagrancë e detyrueshme, që justifikohet nga prania e *gjendjes së flagrancës, krimi të ndëshkueshëm me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet dhe dashjes*, përmbush njëkohësisht edhe kushtet e caktimit të masës së sigurimit (Lara, Dh., 2010). Në nenin 259/3 të KPrP parashikohet se kur arrestimi është kryer në mënyrë të ligjshme, gjykata merr vendim për vleftësimin e masës.

Në nenin 251/2 të KPrP është parashikuar e drejta e policisë gjyqësore të kryejë arrestimin në flagrancë të kujtdo për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një veprë penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum së dhjetë vjet. Kjo formë e arrestimit në flagrancë është quajtur arrestimi në flagrancë fakultativ, për shkak se është në vlerësimin e policisë gjyqësore të kryejë këtë veprim procedural. Arrestimi në flagrancë fakultativ ndryshon nga arrestimi në flagrancë i detyrueshëm, i trajtuar më sipër, pasi në këtë të fundit, policia gjyqësore ka detyrim të realizojë arrestimin. Ligji nuk përcakton ndonjë kriter përzgjedhës për të dalluar rastin kur duhet aplikuar arrestimi në flagrancë fakultativ nga ai kur nuk duhet, gjë që mbetet në diskrecionin e policisë gjyqësore që duhet të vlerësojë në çdo rast konkret nevojat e mbrojtjes dhe kujdesin ndaj publikut (Lara, Dh., 2010). Në vështrim të parë formulimi i dispozitës lë përshtypjen se policia gjyqësore ka një diskrecion të gjerë në vlerësimin e secilit rast. Megjithatë, është e qartë se parametrat vlerësues të "*rëndësisë së faktit*" ose të "*rrezikshmërisë së subjektit*", që deduktohen nga rrethanat e faktit dhe personaliteti i autorit, përbëjnë kufizimin e diskrecionit të policisë gjyqësore (Conso, G., dhe Grevi, V., 2011). Për të vlerësuar ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë fakultativ nuk është e nevojshme prania e përbashkët e *rëndësisë së faktit* dhe *rrezikshmërisë së subjektit*, por është i mjaftueshëm vetëm njëri prej këtyre kushteve (Conso, G., dhe Grevi, V., 2011).

5. Kuptimi i arrestimit të kryer nga qytetarët (citizen's arrest)

Sa më sipër, u trajtuan rregullat e parashikuara nga legjislati shqiptar, të cilat theksojnë se ndalimi apo arrestimi i personave të cilët kanë kryer një veprë penale apo janë në kryerje të një veprë penale, e kanë të drejtë dhe detyrim organet ligjzbatuese sipas parashikimeve ligjore. Konkretisht, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore. Padyshim që ligji ka ngarkuar me ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike Policinë e Shtetit dhe organe të tjera ligjzbatuese. Hetimi i veprave penale, ekzekutimi i vendimeve penale të gjykatave, ndalimi, arrestimi në flagrancë, janë atributet e organeve ligjzbatuese, si Prokuroria dhe policia gjyqësore.

Pra, në rastin klasik dhe më të zakonshëm arrestimi në flagrancë është e drejtë dhe sipas detyrimit i oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët kanë formimin e duhur për të vlerësuar ekzistencën e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara nga ligjvënësi.

Megjithatë, ligjvënësi ka parashikuar një përjashtim nga rregulli i mësipërm, duke i dhënë në raste të caktuara çdo qytetari të drejtën për të kryer arrestimin e një personi që ka kryer apo është duke kryer një veprë penale.

Kështu çdo qytetar, pavarësisht nëse është punonjës i organeve ligjzbatuese apo jo, është i detyruar të kallëzojë një krim, për të cilin vjen në dijeni, në organet ligjzbatuese, të dëshmojë në mënyrë të vërtetë rrethana që ka mësuar në lidhje me një veprë penale, të mos kryejë veprime që fshehin të vërtetën apo që përbëjnë përkrahje të autorit të krimit, në rast të kundërt veprimet e tij përbëjnë veprë penale, dhe janë të dënueshme sipas Kodit Penal (përjashtuar rastet e përcaktuara në ligj).

Përveç detyrimit që kanë qytetarët për rastet e mësipërme, ligji i ka njohur edhe të drejtën (jo detyrimin) për të kryer veprime, të tilla në natyrë, që i kryejnë personat me atributet e policisë gjyqësore. Konkretisht në paragrafin 4 të nenit 251 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi i ka njohur të drejtën çdo qytetari të arrestojë në flagrancë persona të cilët janë në kryerje të një krimi, ose që janë në ndjekje të sipër apo që kapen me prova materiale me të cilat është kryer vepra penale. Vepra penale duhet të jetë e tillë që dënohet në maksimum më shumë se pesë vjet.

Parashikimi i mësipërm përbën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm dhe në ndryshim nga detyrimet e parashikuara më sipër për çdo qytetar, ky përjashtim përbën të drejtë të qytetarit dhe jo detyrim.

Duhet theksuar se ky parashikim gjen zbatim edhe në legjislati të tjera. Arrestimi nga qytetarët, i njohur si "*citizen's arrest*" ka fillimet që në kohën e mesjetës dhe është trajtuar edhe në jurisprudencën e vendeve të ndryshme, sidomos të vendeve me system ligjor common law.

Në Vendimin Malley v. Lane, Gjykata e Lartë e Connecticut, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës arrin në konkluzionin se një person në prezencën e të cilit dikush kryen një vjedhje, mundet që pa mandat, të arrestojë ose të mbajë personin, derisa të vijë një oficer policie në vendin e ngjarjes (Coppolo, G., 1998).

Në një çështje tjetër, sipas vendimit Wrexford v. Smith, 2 Root 171 (1795) specifikohet e drejta e pronarit të sendeve të vjedhura, që të ndjekë dhe ta arrestojë autorin e vjedhjes pa një mandat (Coppolo, G., 1998).

Në një çështje tjetër, në vendimin State v. Ghiloni, 35 Conn. Sup. 570 (1978), një gjyqtar i Gjykatës së Lartë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ri-citoi rregullin se një qytetar ka të drejtë të kryejë një arrestim ose të ndalojë largimin e dikujt që ai ka parë se ka kryer një veprë penale (Coppolo, G., 1998).

Madje qytetarëve ju njihet e drejta për të përdorur forcë të arsyeshme, kur qytetari çmon se është e nevojshme kryerja e një arrestimi të dikujt që në mënyrë të arsyeshme besohet se ka kryer një vepër penale (Coppolo, G., 1998).

Sa më sipër, rezulton e qartë që qytetarët kanë ligjërisht të drejtë të marrin rolin e oficerit të policisë gjyqësore sipas doktrinës së "citizen's arrest" (Robbins, Ira P. (2016). Qytetarët kanë të drejtën, por jo detyrimin, që për vepra penale të caktuara të kryejnë arrestim. Kjo e drejtë zbatohet sipas kushteve dhe rregullave të caktuara, në legjislacione të ndryshme (Robbins, Ira P. (2016).

Në ndryshim nga oficerët e policisë gjyqësore, qytetarët nuk kanë edukimin dhe trajnimin e duhur për të vlerësuar plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, për ekzistencën e kushteve të arrestimit në flagrancë, sic kërkon neni 251/4 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, një vlerësim eventual i gabuar i faktit penal nga ana e qytetarit, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi penale.

Mendojmë që nëse ka apo nuk ka elementë të veprës penale në rastin konkret, i përket hetimit të organit të akzuës dhe vendimmarrjes së këtij organi ose të gjykatës, dhe jo qytetarëve që kanë bërë ndalimin apo oficerëve të policisë gjyqësore që kanë bërë referimin e materialit kallëzues.

Fakti se në një rast eventual, mund të konkludohet se nuk ka patur elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal apo të ndonjë vepre tjetër, nuk i ngarkon qytetarët me përgjegjësi penale. Në bazë të nenit 251, por edhe të jurisprudencës të brendshme dhe të huaj, në momentet e para kërkohet vetëm që të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova dhe jo që fakti të jetë tej çdo dyshimi të arsyeshëm vepër penale.

I njejtë qëndrim është mbajtur edhe në jurisprudencën e huaj. Kështu në një vendim të Gjykatës së Apelit të Karolinës së Jugut në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjykata nuk e konsideron të paligjshëm një arrest të kryer nga një qytetar, kur ka patur arsye të bazuara për të besuar se është kryer një krim dhe se personi i arrestuar është fajtor, pavarësisht se në përfundim ka rezultuar se nuk ishte kryer asnjë krim (Vendimi State v. McNeil, 445 S.E.2d 461 (1994), Gjykata e Apelit e Karolinës së Jugut).

Në gjykimin tonë, në përputhje edhe me doktrinën dhe praktikën e huaj lidhur me konceptin e *citizen's arrest*, sipas legjislacionit tonë procedural, individit nuk mundet të vlerësojë nëse fakti përbën apo jo vepër penale dhe cilësimin ligjor të saj, pasi kjo është përtej kapacitetit të tij profesional dhe ligjor. Në këto raste, gjykimi duhet të shtrihet kryesisht në aspektin subjektiv të veprimeve të një qytetari që ka kryer arrestimin, pra, nëse ka vepruar me bindjen se personi autor ka kryer një krim.

Përfundime

Në konkuzion të atyre që kemi trajtuar më sipër në lidhje me arrestimin në flagrancë e gjejmë me vend të theksojmë disa karakteristika të rëndësishme për kuptimin e drejtë të këtij koncepti. Në mënyrë që arrestimi në flagrancë të kryhet në mënyrë të ligjshme nga shërbimet e policisë gjyqësore është e domosdoshme të plotësohen në **mënyrë kumulative këto** kushte: Konstatimi i kryerjes së një vepre penale nga ato që tregohen në nenin 251 të Kodit të Procedurës Penale, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm e të bazuar se vepra penale është kryer nga personi që arrestohet; ekzistenca e gjendjes së flagrancës. Në përputhje me këto kushte, policia gjyqësore në situatën e flagrancës duhet të vlerësojë, nëse fakti përbën apo jo vepër penale dhe vetëm pas përcaktimit

pozitiv, asaj i nevojitet që të bëjë një vlerësim të përafërt të cilësimit ligjor të saj. Të njëjtat kushte dhe elemente nuk mund t'i kërkojnë edhe individëve për kryerjen e *citizen's arrest*, për shkak se ligjërisht është detyrë parësore e shërbimeve të policisë, të cilat presupozohet se kanë kualifikimin e nevojshëm profesional për të kryer vlerësimet e duhura të flagrancës.

Referenca

- Vendime të GJEDNJ Ječius k. Lituanisë, § 50; Schëabe e M.G. k. Gjermanisë, § 72.
Vendime të GJEDNJ Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit, § 88; Erdagöz k. Turqisë, § 51; Fox, Campbell e Hartley k. Mbretërisë së Bashkuar, § 32
Vendime të GJEDNJ Creangă k. Rumanisë [DhM]*, § 92; Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulëta, § 58.
Vendime të GJEDNJ Guzzardi k. Italisë, § 93; Rantsev k. Qipros dhe Rusisë, § 314; Stanev k. Bullgarisë [DhM], § 115.
Vendime të GJEDNJ Guzzardi k. Italisë, § 95.
Vendime të GJEDNJ Guzzardi k. Italisë, § 92; Medvedyev me të tjerë k. Francës [DhM], § 73; Creangă k. Rumanisë [DhM], § 91.
Vendime të GJEDNJ Nada k. Zvicrës [DhM], § 226; Austin me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], § 59.
Vendime të GJEDNJ Storck k. Gjermanisë, § 74; Stanev k. Bullgarisë [DhM], § 117.
Çështja Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 11209/84; 11234/84; 11266/84; 11386/85), 29 Nëntor 1988; Çështja Murray dhe kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 14310/88), 28 Tetor 1994.
Vendimi State v. McNeil, 445 S.E.2d 461 (1994), Gjykata e Apelit e Karolinës së Jugut
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 02.04.2012
Islami, H., Hoxha, A., Panda, I., Procedura penale, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, 2007, fq. 379.
Lara, Dh., Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 742
Conso, G., Grevi, V., Commentario breve al codice di procedura penale, 7 edizione, CEDAM, 2011, fq. 1508
Spiro, S., "Disa çështje të rregullimit juridik dhe zbatimit në praktikë të masës së ndalimit", Drejtësia Popullore, nr. 4, tetor-Dhjetor, viti 1983, fq. 67.
Sinan Baboçi, "Kontrolli i prokurorit mbi ndalimet", Drejtësia Popullore, nr.2, Prill-Qershor, viti 1979, fq. 99.
Mosko, T., Kolaneci, Florian., "Kriteret dhe kushtet ligjore për zbatimin e masës së ndalimit sipas Kodit të ri të Procedurës Penale dhe kontrolli i prokurorit mbi ndalimet", Drejtësia Popullore nr. 4, Tetor-Dhjetor, viti 1980, fq. 71.
Laronga, A., "Le misure precautelari: aspetti problematici, 'Il sistema cautelare personale", Roma, 14-16 korrik 2008, CONSIGLIO SUPERIORE DELLA MAGISTRATURA, Ufficio per gli Incontri di Studio, fq. 2-3.
Coppolo, G., Citizen's Arrest-Standards, 1998
<https://www.cga.ct.gov/PS98/rpt%5Colr%5Chtm/98-R-0959.htm>
Robbins, Ira P. (2016) "Vilifying the Vigilante: A Narrowed Scope of Citizen's Arrest," *Cornell Journal of Law and Public Policy*: Vol. 25 : Iss. 3 , Article 1.
<https://scholarship.law.cornell.edu/cjlp/vol25/iss3/1/>

E drejta për punë e të dënuarve në Shqipëri: Kudrit Ligjor dhe Zbatimi i tij në praktikë, nën Këndvështrim të Standardeve Ndërkombëtare

Dr. Bojana Hajdini

Lektor - Departamenti i Drejtësisë, Universiteti Epoka

Abstrakt

Personat e dënuar me burgim, referuar standardeve ndërkombëtare, duhet të trajtohen me humanizëm e dinjitet, duke u garantur një sërë lirish dhe të drejtash. Koha e vuajtjes së dënimit duhet t'i shërbejë rehabilitimit të tyre dhe përgatitjes për t'u riintegruar në shoqëri. Një ndër të drejtat që i njihet të dënuarve është dhe ajo e punësimit, qëllimi primar i së cilës është zhvillimi i aftësisë për punë, në mënyrë që ata të kenë mundësi të fitojnë mjetet e jetesës pas lirimit nga burgu.

Ky artikull synon të analizojë shkallën e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar mbi punësimin e të dënuarve, në raport me standardet ndërkombëtare të fushës, si dhe nivelin e zbatimit në praktikë të garancive të vendosura në legjislacion.

Ndërkohë që konstatohet se ai kryesisht i përmbahet standardeve ndërkombëtare, zbatimi në praktikë i tij ka qenë i pjesshëm dhe nuk ka përmbushur qëllimin kryesor që synohet nëpërmjet punësimit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Vetëm së fundmi vërehet që legjislacioni është plotësuar me rregulla të detajuara, të cilat kanë rritur nivelin e zbatimit, në respektim të garancive të vendosura. Rekomandohet që autoritetet, të orientojnë praktikën e punësimit të të dënuarve, drejt përmbushjes së funksionit të rehabilitimit dhe riintegrit.

Fjalë kyçe: Punësim, të dënuar me burgim, standarde ndërkombëtare, rehabilitim, riintegrim.

I. Hyrje – trajtimi me humanizëm dhe të drejtat e të dënuarve

Standardet ndërkombëtare u garantojnë personave të dënuar me burgim trajtim me humanizëm dhe dinjitet.¹ Ato kërkojnë që koha e qendrimit në burg të organizohet në mënyrë të tillë që të garantojë në radhë të parë riedukimin dhe riintegrimin e të dënuarve në shoqëri.² Për këtë arsye, sistemi peniteciar duhet të kujdeset që periudha e vuajtjes së dënimit të organizohet në mënyrë të tillë që të shmangë shkaqet që mund t'i kenë çuar ata në kryerjen e krimit, si dhe efektin që shkakton një mjedis i mbyllur si burgu.

Në këtë aspekt të dënuarve me burgim, edhe pas privimit të lirisë, vazhdojnë t'iu njihen një sërë lirish dhe të drejtash. Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (GJEDNJ), në praktikën e saj, ka konfirmuar se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk pushon së ndaluarit në portën e burgut.³ Gëzimi i këtyre të drejtave i përshtatet natyrës së mbyllur të institucioneve të vuajtjes së dënimit, si dhe rregullave që vihen në funksion të ruajtjes së sigurisë së shoqërisë, apo asaj brenda institucioneve. Të drejtat dhe liritë që kanë të dënuarit, mënyra e ushtrimit të tyre,

¹ UNGA(1966), International Covenant on Civil and Political Rights (ICCPR gjendet [Online] <https://ëëë.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>: <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>) neni 10.

² Po aty.

³ Khodorkovskiy and Lebedev v. Russia, Application nos. 11082/06 and 13772/05, para 836; Klibisz v. Poland, Application No. 2235/02, para 354.

apo kufizimet që mund t'iu bëhen, nuk varen nga vullneti i institucioneve shtetërore apo punonjësve të tyre. Ato janë të parashikuara shprehimisht në legjislacionin e çdo shteti, në përputhje me garancitë që japin dokumentat ndërkombëtare.

Një ndër të drejtat që standardet ndërkombëtare garantojnë për të dënuarit është e drejta e tyre për të punuar. Punësimi përgjatë kohës së vuajtjes së dënimit i vendos të dënuarit në rrethana të ngjashme me jetën jashtë burgut dhe i shërben një sërë qëllimesh, si: (i) fitimi i të ardhurave për vete apo familjen, (ii) fitimi apo ruajtja e aftësive profesionale, (iii) kalimi i kohës në një mënyrë të dobishme, etj. Në këtë kontekst, punësimi i shërben drejtpërdrejt procesit të rehabilitimit dhe riintegrit të të dënuarve në shoqëri.

Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë të drejtën për punë të të dënuarve, në Shqipëri, nën këndvështrim të standardeve ndërkombëtare. Metoda kryesore e përdorur në këtë artikull është analiza ligjore krahasuese. Punimi ndahet në tre pjesë. Në pjesën e parë përshkruhet e drejta për punë, sipas standardeve ndërkombëtare. Në pjesën e dytë, analizohen garancitë e parashikuara në legjislacionin shqiptar, në vështrim krahasimor me standardet ndërkombëtare, në funksion të përpunimit të gjetjeve që rezultojnë nga ky proces. Në pjesën e tretë, analizohen problematikat të cilat has zbatimi në praktikë i kësaj të drejte për të dënuarit.

II. E drejta për punë e të dënuarve, referuar standardeve ndërkombëtare

Dokumentat kryesorë të të drejtave të njeriut njohin të drejtën për punë të individit, pa vendosur kufizime për ushtrimin e saj.⁴ Nga ana tjetër ato ndalojnë punën e detyruar, në çfarëdolloj forme të saj, duke përjashtuar vetëm punën e kryer në bazë të një vendimi gjyqësor, ose gjatë lirimit me kusht, nën mbikqyrje apo kontroll të autoriteteve publike.⁵ Në këtë mënyrë, standardet ndërkombëtare konfirmojnë ndalimin e punës së detyruar, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Njëkohësisht, ato e njohin atë si një element të rëndësishëm të periudhës së vuajtjes së dënimit, në kuadër të rehabilitimit dhe riintegritit⁶.

Garantimi i të drejtës së punës, vendos shtetin përballë detyrimit të ofrimit të mundësisë për t'u punësuar pa diskriminim, si dhe në përputhje me nevojat e

⁴ UN (1948) Universal Declaration of Human Rights (UDHR). gjendet [Online]: <https://ëëë.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>. Neni 23; UNGA (1966) The International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights Gjendet [Online] në: <https://ëëë.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-economic-social-and-cultural-rights>, nenet 6 dhe 8; CoE (1961) European Social Charter (Revised). gjendet [Online] në: <https://rm.coe.int/168047e169>, Pjesa e Parë.

⁵ International Covenant on Civil and Political Rights, neni 8; ILO (1930) Forced Labour Convention, (No. 29), gjendet [Online]: https://ëëë.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C029, European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, as amended (ECHR), gjendet [Online]: <https://ëëë.refworld.org/docid/3ae6b3b04.html>, neni 4,, pika 1 dhe 4

⁶ Rëndësia e punës në rehabilitimin social është njohur që në vitin 1975 me Rezolutën (75)25 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi punën në burgje”, e cila në preambulën e vet thekson “vlerën e punës, si një element të rëndësishëm dhe relevant në trajnimin dhe rehabilitimin e të dënuarve dhe si një pjesë të rëndësishme të menaxhimit operacional të institucioneve penale” duke e vënë theksin tek rëndësia e madhe e “zhvillimit të rolit të punës në rregjimin penal” . Shih:

Committee of Ministers of Council Of Europe (1975) Resolution Res(75)25 on Prison Labour. Gjendet [Online]: http://prison.eu.org/spip.php?page=imprimer_article&id_article=6727.

sigurisë që burojnë nga rregjimi i burgut. Megjithatë, siç ka theksuar edhe Komiteti për Prandalimin e Torturës, në asnjë rast, siguria në institucionet e vuajtjes së dënimit, nuk duhet të shërbejë si arsye për mohimin apo kufizimin e kësaj të drejte.⁷

Standardet mbi të drejtën e punës së të dënuarve, janë sanksionuar në një sërë aktesh të organizatave ndërkombëtare të cilat, edhe pse janë të një natyre rekomanduese u adresohen shteteve për t'u zbatuar si një minimum bazë. Dokumenta kryesorë të "soft law-t", ku përmbledhen standardet e trajtimit të të dënuarve janë: "Parimet Bazë të Trajtimit të të Burgosurve" (PBTB)⁸ dhe "Rregullat Standard Minimum për Trajtimin e të Burgosurve", dokumenta këto të miratuara nga Kombet e Bashkuara,⁹ si dhe "Rregullat Evropiane të Burgjeve" (REB), të miratuara nga Këshilli i Evropës.¹⁰

Sipas këtyre standardeve, puna e të dënuarve duhet të shihet nën optikën e një elementi pozitiv, që i shërben riintegritimit, duke e shkëputur njëherë e mirë nga koncepti i ndërshkimit apo si një mjet që çënon dinjitetin e njeriut.¹¹ Në kushtet e burgjeve, e drejta e punës, shndërrohet në një detyrim pozitiv për shtetin, i cili duhet të ofrojë mundësinë e përfshirjes në aktivitete punësimi për të gjitha kategoritë e të dënuarve, gjithmonë duke garantuar njëkohësisht edhe të drejtat që burojnë nga një marrëdhënie punësimi.

Referuar rregullave të sanksionura nga dokumentat e mësipërm, rekomandoet që shtetet të mundësojnë punësimin e të dënuarve, duke garantuar:

- të drejtën e të dënuarve për përzgjedhjen e një punë kuptimplotë, në varësi të asaj që ofrohet nga autoritetet, bazuar në aftësitë profesionale, duke ndaluar çdo lloj diskriminimi në ofrimin e saj;
- të drejtën për t'u paguar, në masën e duhur për punën e kryer, si dhe përdorimin e të paktën një pjese të saj;
- respektimin e moshës, gjendjes shëndetësore, aftësive fizike dhe mendore në përfshirjen në aktivitete punësimi;
- ushtrimin e saj në kushte të ngjashme me atë që kryhet jashtë burgjeve, si dhe ofrimin e kushteve të sigurisë teknike dhe shëndetësore, ashtu si edhe për punëmarrësit e zakonshëm;

⁷ Komiteti për Prandalimin e Torturës në "Normat e KPT-së, Pjesët "kryesore" të Raporteve të Përgjithëshme të KPT-së," thekson se: "Pasja e një programi veprimtarish është po kaq e rëndësishme – ndoshta dhe më tepër – në një njësi sigurie të lartë sesa në një njësi të zakonshme. Një program i tillë mund të bëjë shumë për të penguar pasojat e dëmshme që shkakton mbi personalitetin e një të ndaluarit, jeta në një ambient të kufizuar në një njësi të tillë. Veprimtaritë e propozuara duhet të jenë tepër të ndryshme (edukim, sport, punë me vlerën e një formimi profesional, etj.). Me sa ka të bëjë sidomos me punën, është e qartë që arsyet e sigurisë mund të përjashtojnë shumë tipe punësh që gjehen në një institucion normal për vuajtjen e dënimit. Megjithatë, kjo nuk duhet të nënkuptojë që të ndaluarit të kryejnë vetëm punë të një natyre të mërzitshme. Shih: Këshilli i Evropës (2004), "Normat e KPT-së: Pjesët "kryesore" të Raporteve të Përgjithëshme të KPT-së". CPT/Inf/E (2002) 1 – Rev. 2004, gjendet online: <https://docplayer.fr/114091307-Komiteti-europian-per-parandalimin-e-tortures-dhe-te-trajtimit-ose-denimit-cnjerezor-dhe-poshterues-kpt-normat-e-kpt-se.html>, para 32.

⁸ UNGA Res 45/111 (1990) Basic Principles for the Treatment of Prisoners. gjendet [Online]: <https://ëëë.ohchr.org/sites/default/files/basicprinciples.pdf>, Parimi 8.

⁹ Shih: ESC Res 663 C (XXIV) and 2076 (LXII) (1957 and 1977). Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners, [Online] gjendet: https://ëëë.unodc.org/pdf/criminal_justice/UN_Standard_Minimum_Rules_for_the_Treatment_of_Prisoners.pdf, Rregullat 73-76.

¹⁰ Council of Europe: Committee of Ministers (2006), *Recommendation Rec(2006)2 of the Committee of Ministers to Member States on the European Prison Rules*, gjendet [Online]: <https://ëëë.refworld.org/docid/43f3134810.html>, rregullat 26.1-26.17 dhe 105.1-105.6.

¹¹ Po aty, rregulli 26.1.

- mundësinë e përfitimit nga skema e sigurimit shëndetësor, apo kompensimin e të burgosurve nga dëmtimet në punë, sëmundjet profesionale, me kushte jo më pak të favorshme se ato të zbatuara për punëtorët jashtë mjedisit të burgjeve;
- orët e punës dhe pushimit ditor e javor, në përputhje me standardet që vendos legjislacioni vendas për këdo të punësuar;
- dhënien e prioritetit të aktiviteteve të punës që përfshin dhe trajnimet profesionale
- të drejtën e përfitimit, për aq sa është e mundur, prej skemës së sigurimeve shoqërore.¹²

Puna në burgje është trajtuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Kjo gjykatë ka marrë në disa prej çështjeve të saj në shqyrtim faktin nëse puna e kryer nga të dënuarit bie apo jo në kategorinë e punës së ndaluar, të parashikuar nga neni 4, paragrafi 3/a i KEDNJ. Megjithatë i ka marrë në analizë dhe për referencë standardet e rekomanduara nga Rregullorja Evropiane e Burgjeve, ajo nuk ka konsideruar shkelje mospërbushjen e tyre nga shtetet, duke i trajtuar ato në përputhje me statusin rekomandues që ato dokumenta kanë, si legjislacion “soft law”. Gjykata ka konsolidur qëndrimin se “puna në burgje, e cila synon rehabilitimin, bie nën zbatim të nenit 4(3)a të Konventës Evropiane dhe nuk përbën shkelje të saj”.¹³ Sipas saj “neni 4, paragrafi 3/a në kontekstin e “punës së detyruar” nuk përfshin punën që bëhet në kuadër të “rrjedhës së zakonsme të dënimit”, duke iu referuar për këtë të fundit standardeve të vendosura në shtetet antare”.¹⁴ Kështu GJEDNJ nuk ka gjetur shkelje të nenit 4 të KEDNJ, sa i takon pretendimeve për një vlerë pagë më të lartë sesa ajo e ofruar,¹⁵ punën e cila shpërblehet me ulje të masës së dënimit,¹⁶ punën e kryer pas arritjes së moshës së pensionit¹⁷, apo atë të të papërfshirë në skemën e sigurimeve shoqërore,¹⁸ duke mos i konsideruar ato si “punë të detyruar”, por “punë të kryer në kuadër të rrjedhës normale të dënimit.

GJEDNJ pranon se “puna në burgje, ndryshon nga puna e kryer nga punëdhënësit e zakonshëm, në shumë aspekte. Ajo i shërben qëllimit kryesor të rehabilitimit dhe risocializimit. Orët e punës, shpërblimi dhe përdorimi i pjesshëm i shpërblimit reflekton kontekstin e burgut.”¹⁹ Ndërkohë ajo ka konfirmuar detyrimin e shtetit për marrjen e masave për sigurinë në punë, në përbushje të detyrimit për garantimin e mirëqënies së të dënuarve.²⁰ Gjithashtu, edhe pse nuk ka gjetur shkelje të nenin 11 të Konventës, sa i takon të drejtës për t’u organizuar në sindikata të të dënuarve, ajo sugjeron që “në të ardhmen mund të jetë e nevojshme zgjerimi i lirisë sindikale për të burgosurit që punojnë, veçanërisht nëse ata punojnë për një punëdhënës privat”.²¹

¹² Për më tepër shih rregullat 26.1-26.17 dhe 105.1-105.6 të Rregullave Evropiane të Burgjeve si dhe rregullat 73-76 të Standardeve Minimum për Trajtimin e të Burgosurve.

¹³ De Èilde, Ooms and Versyp (“Vagrancy”) V. Belgium, Application no. 2832/66; 2835/66; 2899/66 [1971], para 90.

¹⁴ Stummer v. Austria, Application no. 37452/02 [2011], para 119.

¹⁵ Stummer v. Austria, paras 124-134.

¹⁶ Floroiu v. Romania, Application no. 15303/10 [2013], para 35.

¹⁷ Meier v. Sëitserland, Application no. 10109/14, [2016], paras 72-79.

¹⁸ Stummer v. Austria, para 131.

¹⁹ ECHR (2022) “Guide on the case-law of the European Convention on Human Rights: Prisoners’ rights. para 301.

²⁰ Gorgiev v. the former Yugoslav Republic of Macedonia, Application no. 26984/05 [2012], para 68.

²¹ Yakut Republican Trade-Union Federation v. Russia, Application no. 29582/09 [2021] paras 29; 39-48.

III. E drejta për punë e të dënuarve sipas sipas legjislacionit Shqiptar

Shqipëria ka një legjislacion të dedikuar për trajtimin e të dënuarve. Ligji i mëparshëm (Ligj 8328/1998 shfuqizuar)²² dhe ai aktualisht në fuqi (Ligji 81/2020),²³ që trajtojnë të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, i kushton një rëndësi të madhe mbrojtjes të tyre, në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht, të cituara më sipër. Trajtimi i të dënuarve, që nga koha e vendosjes në paraburgim dhe deri pas lirimimit duhet të t'i shërbejë rehabilitimit dhe riintegrimin e tij në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike.²⁴ Në funksion të këtyre të fundit, ai njih mundësinë e personave të dënuar për të punuar, duke parashikuar garancitë bazë në kudër të kësaj të drejte²⁵. Aspekte që lidhen me kushtet e punës, kohëzgjatjen apo shpërblimin e punës, rregullohen nëpërmjet vendimit nr. 602, datë 13.10.2021 të Këshillit të Ministrave²⁶.

Punësimi i të dënuarve në kuadër të riintegrimin është një detyrim pozitiv për shtetin. Përveç mundësimin të saj, nëpërmjet ofrimit të mundësisë së punësimin, vetë apo në marrëveshje me operatorë private, autoritetet shtetërore duhet të grantojnë përmbushjen e qëllimit të saj si dhe një sërë lirish dhe të drejtash, të cilat do të analizohet në vijim. Institucionet e vuajtjes së dënimit është e rëndësishme të projektohen, ndërtohen, si dhe rikonstruktohen në mënyrë që të plotësojnë standardet për punësimin²⁷. Për këtë, një rëndësi të madhe duhet të luajë financimi i tyre, me fokus punësimin e të dënuarve.

Në vijim do të analizojmë rregullat e parashikuara në legjislacionin shqiptar lidhur me punësimin e të dënuarve, në këndvështrim të standardeve që rekomandojnë "Parimet Bazë të Trajtimin të të Burgosurve" (PBTB), "Rregullat Standard Minimum të Trajtimin të të Burgosurve" (RSMTB), si dhe "Rregullat Evropiane të Burgjeve" (REB).

Tabela 1 krahason legjislacionin vendas me standardet, në këndvështrim të konceptit të punësimin në mjediset e burgjeve.

²² Ligji nr.8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i shfuqizuar.

²³ Ligj 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" Fletore Zyrtare Nr. 137.

²⁴ Ligji 81/2020, neni 12.

²⁵ Ligji 81/2020, nenet 42 dhe 43.

²⁶ VKM 602/2021 "Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj", Fletorja Zyrtare Nr. 161.

²⁷ Ligji 81/2020, neni 32, pika 1.

Tabela 1: Punësimi – e drejtë apo detyrim?

Standardet ndërkombëtare	Legjislacioni shqiptar
<p>Siç theksuam më sipër në këtë punim, standardet ndërkombëtare ndalojnë punën e detyruar duke konfirmuar se puna e bërë nga të burgosurit, nuk është e ndaluar. Sipas tyre të dënuarit mund përfshihen në aktivitete punësimi, e cila shihet si element pozitiv i rregjimit të burgjeve dhe jo si ndërshkim (REB 26.1), (Parimi 8 i PBTB; REB 26.1, 26.2; RSMTB 71/1).</p> <p>Autoritetet e burgut duhet të ofrojnë mjaftueshëm punë të një natyre të dobishme, e cila në çdo rast shpërblehet (REB 26.2; RSMTB 71/3).</p> <p>Në kuadër të rregjimit të burgut, ata mund tu kërkojnë të dënuarve që nuk kanë mbushur moshën e pensionit të punojnë, nëse kjo përputhet me kushtet fizike dhe mendore, të përcaktuara nga personeli mjekësor (REB 105.2, 105.3, 105.4 RSMTB 71/3, 71/6)</p> <p>Të dënuarit mund të zgjedhin llojin e punës brenda mundësive të asaj që lejohet, trajnimit të tyre dhe rregullave për mbajtjen e rregullit dhe disiplinës (REB 26.6).</p>	<p>Shqipëria ndalon në mënyrë eksplicite punën e detyruar apo si ndërshkim në institucionet e vuajtjes së dënimit (Ligji nr. 81/2020, neni 43/1). I dënuari zgjedh ose jo të kryejë punë, e cila në çdo rast duhet të jetë e denjë (Ligji nr. 81/2020, neni 43/1).</p> <p>Punësimi bëhet gjithmonë mbi baza pëlqimi të dhënë nga i dënuari, ndërkohë përzgjedhja e individëve që shprehin vullnetin të punojnë bëhet në përputhje me vendet e punës në dispozicion, të siguruara nga institucionet e vuajtjes së dënimit, bazuar në një procedurë selektive të tyre, ku merren në konsideratë kritere si: gjendja ekonomike të familjes së dënuarit, koha e qëndrimit në institucion, koha e angazhimit gjatë vuajtjes së dënimit, personaliteti, sjellja dhe rrezikshmëria e të burgosurit, aftësia profesionale, fizike e mendore, eksperiencia e mëparshme në punë, mundësitë objektive si dhe çdo element tjetër për kryerjen e punës. (Ligji 81/2020, neni 43/1; VKM 602/2021, kreu II/7)</p>

Burimi: Përgatitur nga vetë autori bazuar në standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas

Siç vërehet, legjislacioni shqiptar, shkon në të njëjtën linjë me standardet, sa i takon ndalimit të punës së detyruar apo si ndërshkim. Punësimi shihet si mundësi për të dënuarit, gjithmonë mbi bazën e pëlqimit të dhënë prej tij. Ligji nuk parashikon kryerjen e punës me kërkesë të institucionit, si pjesë e jetës së përditshme të rregjimit të burgut, apo përfshirjen në punë vullnetare, të pa paguar. Sa i takon natyrës së punës që kryhet, legjislacioni nuk vendos si standard të qenit “e dobishme” për të dënuarin në këndvështrim të riintegritimit, por kërkohet që ajo të jetë “e denjë”, gjë që nënkupton se ajo nuk duhet të jetë e një natyre poshtëruese.

Tabela 2 në vijim, krahason legjislacionin vendas me standardet, në këndvështrim të synimit që duhet të përmbushë qëllimi i të dënuarve.

Tabela 2: Qëllimi i punësimit dhe rëndësia e tij për të burgosurit

Burimi: Përgatitur nga vetë autori bazuar në standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas

Standardet nderkombetare	Legjislacioni shqiptar
<p>Punësimi i të dënuarve, përmbush një sere qëllimesh, megjithatë standardet e vendosin theksin tek fitimi, ruajtja dhe zhvillimi i aftësisë për punë, e cila do të lehtësojë mundësinë e riintegrit në tregun e punës, me qëllim sigurimin e jetesës për vete dhe familjen (REB 26.3; PBTB 8; RSMTB 71/4. 72/1)</p> <p>Organizimi dhe metodat e punës në institucione duhet t'i ngjajnë sa më shumë me ato të punës që kryhet në komunitet, për të përgatitur të burgosurit për një jetë profesionale normale (REB 26.7)</p> <p>Rëndësi i kushtohet punës e cila përfshin edhe formimin profesional, veçanërisht për të burgosurit e rinj, ku në çdo rast qëllimi i trajnimit nuk duhet të jetë rritja e cilësisë së punës, apo përfitimi prej tyre i institucionit apo atyre që e ofrojnë. (REB 26.5, 26.8; RSMTB 71/5, 72/2)</p>	<p>Legjislacioni shqiptar shprehet në mënyrë eksplicite se punësimi i të burgosurit, nuk është i lidhur me shpërblimin, por me nxënien, ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive e të njohurive profesionale gjatë kohës së vuajtjes së dënimit (Ligji 81/2020, neni 43/3; VKM 602/2021, kreu I/2).</p> <p>Një qëllim i tillë i punës duhet të garantohet edhe në rastin e punësimit nga persona juridikë privatë, duke u kërkuar këtyre të fundit, si dhe të burgosurve, kur kërkesa për punësim pranë privatit vjen prej tyre, të provojnë arritjen e këtij qëllimi. (VKM 602/2021, kreu II/11).</p>

Sa i takon qëllimit që duhet të përmbushë punësimi i të dënuarve, legjislacioni shqiptar reflekton standardet nderkombetare. Megjithatë ajo që mungon, të paktën në legjislacion, janë mekanizmat konkretë që ndërlidhin eksperiencën dhe punësimin në periudhën e dënimit, me riintegrimin pas lirit. Standardet e mësipërme kërkojnë që puna në burg duhet të përfshijë trajnimin profesional, që i mundëson atyre të fitojnë kualifikime, për të gjetur punë pas vuajtjes së dënimit. Sipas legjislacionit tonë, edhe pse kërkesat për punësim të të burgosurve, që vijnë nga personat juridikë privatë, kërkohej të provojnë mundësinë e riintegrit të të dënuarve, nuk parashikohen kritere përzgjedhëse që i japin përparësi punës që përfshin edhe trajnimin profesional. Nga ana tjetër, siç përmendëm më sipër, kriter për t'u punësuar është aftësia dhe formimi profesional që ka i dënuari, duke mos i dhënë prioritet atyre që nuk kanë një formim profesional, me qëllim aftësimin apo trajnimin e tyre për punë. Të dënuarit përzgjedhin punën nga sa është në dispozicion, pa pasur njohuri mbi tregun e punës, apo pa u asistuar nga institucioni për gjetjen e punës në fazën e paralirimit. Gjithashtu, legjislacioni shqiptar, nuk parashikon incentiva për inkurajimin e të dënuarve për t'u përfshirë në aktivitete punësimi, sikurse mund të jetë konvertimi i kohës së punës me ulje të masës së dënimit.

Tabela 3 krahason legjislacionin vendas me standardet, përsa i takon kategorive të të dënuarve që kanë të drejtë të punësohen, subjekteve ku ata mund të punësohen, dhe vendit të kryerjes së punës.

Tabela 3: Kush mund të kryejë punë? Ku mund të punësohen të dënuarit dhe në çfarë vendi kryhet puna?

Standardet ndërkombëtare	Legjislacioni shqiptar
<p>Puna në burgje mund të ofrohet nga institucionet e vuajtjes së dënimit vetë, apo në bashkëpunim me kontraktorë privatë, brenda apo jashtë mjediseve të burgut (REB 26.9) Ajo mundësohet pa asnjë lloj diskriminimi gjinor (REB 26.4) Puna u ofrohet edhe të paragurgosurve, me të njëjtat kushte sit ë dënuarit, por mbi bazën e pëlqimit të dhënë prej tyre dhe në asnjë rast nuk mund të kërkohej si pjesë e regjimit të burgut (REB 100.1, 100.2)</p>	<p>I burgosuri mund të punësohet: (i) nga administrata e institucioneve të vuajtjes së dënimit (ii) nga persona juridikë privatë, brenda burgjeve (iii) nga personat juridikë privatë jashtë tyre, në përputhje me rrezikshmërinë e personit dhe nëse nuk çenohet siguria (iv) nëpërmjet vetëpunësimit. (Ligji 81/2020, neni 43/5; VKM nr. 602/2021 Kreu II/1).</p> <p>Punësimi nga personat juridikë privatë bëhet: (i) me kërkesë të këtyre të fundit, kur sipas planit të biznesit kanë nevojë të punësojnë një numri të caktuar të të burgosurve, brenda ose jashtë institucionit, apo (ii) me kërkesë të vetë të burgosurve, si rezultat i nevojës për ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive profesionale, mbi bazën e një procedure vlerësimi nga DPB dhe një komisioni të ngritur për këtë qëllim²⁸, nëse provohet qëllimi i rinteprimit. (VKM 602/2021 Kreu II/10, 13)</p> <p>Kontrata e punës lidhur nga një i dënuar nuk duhet të tregojë se ai është duke kryer dënimin (Ligji 81/2020, neni 43/5). Legjislacioni njeh mundësinë e punësimit për:</p> <ul style="list-style-type: none">- të burgosurit, pa asnjë diskriminim mes grave dhe burrave²⁹- të paraburgosurit me miratim të prokurorit (Ligji 81/2020, neni 43/11; VKM 602/2021 Kreu II, 12- të miturit nëse një gjë e tillë: lehtëson edukimin profesional; punësimin e tij pas lirim; nuk pengon arsimimin e tij; respekton garancitë që parashikon legjislacioni i punës për të miturit. (Ligji 81/2020, neni 43/10; VKM 602/2021 Kreu II, 38-43)- personat me aftësi të kufizuara, nëse vlerësohet se gjendja e tyre e lejon dhe puna i shërben qëllimeve terapeutike. (Ligji nr. 81/2020, neni 43/7; VKM nr. 602/2021 Kreu II 33-37)- të dënuarit që vuajnë dënimin në burgjet e sigurisë së lartë, vetëm brenda institucionit. (Ligji 81/2020, neni 43/5)

Burimi: Përgatitur nga vetë autori bazuar në standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas

Legjislacioni respekton standardet lidhur me llojin e punës që ofrohet dhe mosdiskriminimin në gëzimin e saj, për të gjitha kategoritë e të dënuarve. Ndërkohë nga parashikimet ligjore, duket i vështirë, punësimi i të dënuarve pranë personave juridikë privatë, mbi bazën e një kërkesë që vjen nga vetë i dënuari, sa kohë që këtij të fundit i kërkohej një sërë dokumentesh për depozitim pranë institucionit të vuajtjes së dënimit, dhe që lidhen me gjendjen juridike dhe ekonomike të personit juridik

²⁸ Me anë të VKM 602/2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve krijohet Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Aktivitetit të Punës në Burgje, si organ këshillimor, i cili ka për qëllim të shqyrtojë dhe të vlerësojë çdo kërkesë për punësimin e të burgosurve, sipas parashikimit të këtij vendimi, si dhe të nxisë e të krijojë kushtet për punësimin e të burgosurve. Shih për më tepër vendimin VKM 602/2021, kreu IV.

²⁹ Ligji 81/2020, neni 5, pika 4 parashikon që gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

privat ku mund të ketë interes të punësohet³⁰. Sa kohë që detyrimi mbi ofrimin e mundësisë së punësimit bie mbi institucionin, në funksion të përmbushjes së qëllimit të riintegrit, vendosja e detyrimeve dhe burokracive të tilla që rëndojnë mbi të dënuarin, duket që shkon kundër incentivimit të tyre për të punuar.

Tabela 4 krahason rregullat e parashikuara nga legjislacioni vendas mbi shpërblimin e punës dhe mundësisë së përdorimit të të ardhurave, në raport me standardet

Tabela 4: Si shpërblehet puna e të dënuarve? Si shpërndahen të ardhurat nga punësimi?

<i>Si shpërblehet puna e të dënuarve? Si shpërndahen të ardhurat nga punësimi?</i>	<i>Si shpërblehet puna e të dënuarve? Si shpërndahen të ardhurat nga punësimi?</i>
Standardet nderkombëtare	Legjislacioni shqiptar
Standardet kërkojnë që puna në burgje, në çdo rast duhet të jetë kundrejt shpërblimit (REB 26.10). Të burgosurit duhet të lejohen të përdorin një pjesë të të ardhurave për vetë apo për të ndihmuar familjet e tyre (REB 26.11) Në funksion të ndihmës për riintegrim të dënuarit duhet të inkurajohen të ruajnë një pjesë të të ardhurave për ta përdorur sipas qëllimeve të miratuara, apo kur të dalin (REB 26) Lidhur me shpërndarjen e të ardhurave, standardet ndërkombëtare mbështesin të drejtën e të burgosurit të shpenzojnë të paktën një pjesë të të ardhurave të tyre në artikuj të miratuar përdorimin e tyre dhe për t'i dërguar një pjesë të të ardhurave të tyre familjes së tyre (REB 26.11; RSMTPD: 76.2). Sistemet e burgjeve këshillohen të krijojnë një fond kursimi me qëllim që t'i dorëzohet të burgosurit pas lirimimit (RSMTP: 76.3 dhe REB: 26.12) Në rastin e të burgosurve, një pjesë e shpërblimit të tyre ose e kursimeve nga puna e tyre mund të përdoret për zhdëmtimin e dëmëve të shkaktuara, nëse një gjë e tillë vendoset nga gjykata dhe nëse i burgosuri jep pëlqimin. (REB 105.5)	Puna e kryer gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burgim në çdo rast është e paguar (Ligji 81/2020, neni 43/2, 44/1; VKM 602/2021, kreu III). Shpërblimi për punën llogaritet mbi bazë mujore dhe reflekton sasinë, cilësinë dhe kohëzgjatjen e punës së kryer (VKM 602/2021, kreu III 15, 16). I burgosuri ka të drejtë të disponojë lirshëm jo më shumë se 40 (dyzet) për qind të të ardhurave të fituara nga puna e tij, me qëllim blerjen e sendeve të lejuara për përdorim vetjak, ose për transferimin e këtyre të ardhurave familjarëve të tij (Ligji 81/2020, neni 44/2; VKM 602/2021 Kreu III/20) Sa i takon vlerës së pagës, kur i burgosuri punësohet nga administrata e institucionit të vuajtjes së dënimit, i burgosuri përfiton një pagesë në masën sa 25 % e pagës minimale në shkallë vendi. Në rastet kur i burgosuri punësohet nga një person juridik privat, paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale në shkallë vendi. (VKM 602/2021 Kreu III/17) Në rast se për krijimin e kushteve për punësimin e të burgosurit nga institucioni ose për vetëpunësimin e tij, krijohen kosto për institucionin, shpërblimi i tij do të përdoret për mbulimin e këtyre kostove. (VKM 602/2021 Kreu III/21)

Burimi: Përgatitur nga vetë autori bazuar në standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas

³⁰ Shih për më tepër VKM 602/2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”, Kreu II, pika 20.

Legjislacioni shqiptar, duket se i përmbahet pjesërisht rekomandimeve të bëra nga standardet ndërkombëtare, lidhur me përdorimin e të ardhurave nga punësimi në burgje. Megjithëse ai shprehet mbi mundësinë e përdorimit të 40% të të ardhurave, duke përcaktuar dhe qëllimin e përdorimit të tyre, mbetet e paqartë se çfarë ndodh me 60 përqindëshin tjetër të të ardhurave. Nga ana tjetër, ndërkohë që legjislacioni, vendos kritere mbi përcaktimin e pagës, shpërblimi me 25 përqind të pagës minimale, i vendosur apriori, në rastin punës së kryer në institucion, nuk u përgjigjet këtyre kritereve. Gjithashtu, vlera e saj prej rreth 8000 lekësh³¹ nuk duket se shtyn të dënuarin në angazhimin në aktivitete punësimi.

Ndërkohë, në kushtet kur garantimi i punës për të dënuarit përbën një detyrim pozitiv për shtetin, ku vetë ligji 81/2020 dhe VKM 602/2021 përcakton si detyrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve të vuajtjes së dënimit, krijimin e kushteve dhe mundësive për punësimin dhe vetëpunësimin e të burgosurve³², duket se përdorimi i të ardhura të punësimit për mbulimin e kostove që lidhen me këto kushte, shkon ndesh si me këtë detyrim, ashtu dhe me synimin e riintegrit, që duhet të përmbushë periudha e dënimit dhe aktivitetet e lejuara gjatë saj. Nga ana tjetër kjo vendos këtë kategori të të dënuarve, në kushte të pabarabarta me të dënuarit, që potencialisht punësohen nga kontraktori privat, i cili ka detyrim mbulimin e kostove që lidhen me kushtet e punësimit.

Gjithashtu, nuk gjenden të pasqyruar në legjislacion as rekomandimet e bëra në standardet e sipër cituara, mbi krijimin e një fondi kursimi që i shërben të dënuarit pas lirimit, apo mundësia e krijimit të të ardhurave për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar viktimave, e cila do të mund të lehtësonte barrën e detyrimeve financiare që mund të rëndojnë mbi të.

Tabela 5 krahason legjislacionin shqiptar me standardet, sa i takon kushteve të punës dhe të drejtave që i njihen të dënuarit, në një marrëdhënie punësimi.

Tabela 5: Çfarë kushtesh ofrohen për punësimin? Çfarë të drejtash gëzon i dënuari?

³¹ Vlera e pagës minimale për vitin 2022, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.158, datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, është 32.000 lekë.

³² Ligji 81/2020, nenin 43/6; VKM 602/2021, Kreu III, pika 9.

Çfarë kushtesh ofrohen për punësimin? Çfarë të drejtash gëzon i dënuari?	
Standardet ndërkombëtare	Legjislacioni shqiptar
Standardet ndërkombëtare theksojnë se kushtet në të cilat të burgosurit punojnë duhet t'i nënshtrohet të njëjtave garancive të vendosura nga legjislacioni i shtetit për të punësuarit, lidhur me shëndetin, sigurinë, dëmtimet në punë dhe sëmundjet profesionale (REB 26.13; 26:14; RSMTB: 74/1 dhe 74 2). Gjithashtu, përsa është e mundur për të dënuarit duhet të ofrohet mundësia e përfshirjes në skemat e sigurimit shoqëror. (REB 26.17) Një mbrojtje tjetër e rëndësishme që rekomandohet nga instrumentet ndërkombëtare është koha e punës dhe pushimit, e cila në çdo rast duhet të reflektojë rregullat dhe garancitë e dhëna për të punësuarit e zakonshëm, duke vendosur që në çdo rast detyrimin që t'iu lihet një ditë pushim dhe mjaftueshëm kohë për arsim apo aktivitetet e tjera të lejuara (RSMTB 75/ 1 dhe 75/22; REB 26.15 dhe 26.16)	Legjislacioni ngarkon institucionet e vuajtjes së dënimit dhe personat juridikë privatë, me detyrimin për të garantuar kushtet e punës, transportin, kushtet minimale të sigurisë, higjenes dhe shëndetit në vendin e punës, mundësinë e përballimit të trajtimit mjekësor, pushim përgjatë orarit të punës, si çdo element tjetër të nevojshëm. (VKM 602/2021 Kreu III/7) Ligji njih periudhën e punësimit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si vjetërsi në punë, për efekt pensioni (Ligji 81/2020, neni 43/2) Për të burgosurin e punësuar ofrohen të njëjtat garanci që parashikon legjislacioni në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës, lidhur me kohën e punës, pushimit, mbrojtjen dhe sigurinë në punë (VKM 602/2021 Kreu III/10-14)

Burimi: Përgatitur nga vetë autori bazuar në standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas

Legjislacioni duket se pasqyron rekomandimet ndërkombëtare mbi kushtet e punës, duke i njohur të dënuarive të njëjtat garanci si për të punësuarit jashtë institucioneve, përfshi këtu edhe njohjen e periudhës së punësimit si vjetërsi në punë, për efekt pensioni apo garantimin e të ardhurave në rast aksidenti në punë, apo sëmundje profesionale.

IV. Zbatimi në praktikë i punësimit të të dënuarve në Shqipëri

Më sipër analizua garancitë që ofron legjislacioni shqiptar për punësimin e të dënuarve, në raport me standardet ndërkombëtare. Por si aplikohet në praktikë punësimi i të dënuarve? Ligji 81/2020 dhe VKM 602/2021, siç e përmendëm më sipër, njih dhe ofron një sërë garancish lidhur me punësimin e të dënuarve. Pak a shumë në të njëjtat linja garantohej e drejta për punë edhe nga ligji i mëparshëm për trajtimin e të dënuarve (Ligji nr.8328/1998, i ndryshuar)³³. Megjithatë, deri më sot e drejta e punësimit të dënuarve, është aplikur në mënyrë të kufizuar.

Së pari, legjislacioni i mëparshëm për punësimin, ka qenë i paplotë. Edhe pse ligji jepte disa garanci mbi punësimin, ai nuk ishte i plotësuar me akte nënligjore që rregullonin

³³ Ligji 8328/1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i shfuqizuar, nenet 34-37.

shpërblimin e punës,³⁴ apo punësimin e të dënuarve nga subjektet private. Plotësimi i bazës ligjore është bërë përfundimisht në nëntor të vitit 2021, me anë të Vendimit 602/2021 të Këshillit të Ministrave, miratimi i të cilit mori më shumë sesa një vit, nga koha e miratimit të ligjit. Ky akt, pëveçse plotësoi një autorizim ligjor, sanksionoi për herë të parë një sërë rregullash të detajuara mbi mundësinë e punësimit të të dënuarve nga personat juridike privatë, jashtë apo brenda institucionit, si dhe vendosi rregulla mbi shpërblimin e punës, kushtet dhe kohëzgjatjen e saj. Në këtë mënyrë, iu hap rruga zbatimit në praktikë të garancive të njohura nga ligji, lidhur me punësimin nga subjektet private, si dhe masës së shpërblimit të punës.

Së dyti, praktikata e shpërblimit të punës deri në miratimin e Vendimit 602/2021 të Këshillit të Ministrave, nuk janë zbatuar në mënyrë rigoroze. Një pjesë e personave të dënuar që punonin në burgje shpërbleheshin sipas Vendimit nr.228, datë 19.05.1993 "Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie" të Këshillit të Ministrave, me një shumë të papërfillshme, prej 90 lekësh në muaj, ndërkohë pjesa më e madhe e tyre përfitonin ulje dënimi me rreth 4 ditë në muaj, bazuar në Dekretin nr.7289, datë 08.04.1989 "Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën", të Presidiumit të Kuvendit Popullor³⁵. Të dy këto akte janë miratuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.8328/998 dhe ligjit 81/2020 dhe binin ndesh me parashikimet e bëra në to³⁶. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në një ankesë drejtuar tij, ka gjetur shkelje të parimit të barazisë, faktin se personat e dënuar që kryejnë punë në burg, nuk trajtohen njëjloj me shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgut, sa i takon masës së shpërblimit³⁷.

Së treti, megjithëse puna jashtë institucionit ka qenë e lejuar nga legjislativi, të dënuarit janë përfshirë kryesisht në veprimtari brenda mjediseve të vuajtjes së dënimit. Nga ana tjetër, numri i vendeve të punës ka qenë i kufizuar, për shkak të numrit të ulët të vendeve vakant në organikat e institucionit, por dhe infrastrukturës së dobët të tyre. Sipas nevojave të institucionit, të dënuarit kryesisht janë punësuar në sera, si ndihmës kuzhinier, shpërndarës ushqimi, mirëmbajtës, kopshtarë, mekanikë, muratorë, punonjës biblioteke, pastrues.³⁸ Punë të kësaj natyre, në pjesën më të madhe të tyre, nuk kërkojnë ndonjë formim profesional, dhe nuk përfshijnë zhvillimin e ndonjë aftësie që do të mund t'i ndihmojë të dënuarit të kthehen në tregun e punës. Në këtë kontekst, natyra e tyre nuk i përshtatej standardit të të qenit "e dobishme" në funksion të ndihmës së tyre për t'u riintegruar dhe për të siguruar mjetet e jetesës pas lirimit.

